

2017-2018

RAPORTI I MONITORIMIT AFATMESËM

TË AGJENDËS KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Shtator 2019

Ky dokument është përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë. Dokumenti është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale me ekspertizën dhe asistencën teknike të UNICEF në Shqipëri, përmes Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve. Kjo ndërmarrje është realizuar në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Askush të mos mbetet pas” (LNB), financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë ato të UNICEF-it në Shqipëri.

2017-2018

RAPORTI I MONITORIMIT AFATMESEM

TË AGJENDËS KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE



Leave
No One
Behind

Përmbajtja

SHKURTESA	5	OBJEKTIVI 13:	72
HYRJE	8	<i>Fuqizimi i mekanizmave dhe i kapaciteteve, për të ofruar mbrojtje dhe përkujdes shoqëror më të mirë, ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë</i>	
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	10	OBJEKTIVI 14:	76
METODOLOGJIA	16	<i>Fuqizimi i familjes për të adresuar rreziqet dhe pasojat e varfërisë, si dhe për të parandaluar ndarjen e fëmijës nga familja</i>	
ZËRI I FËMIJËVE	22		
OBJEKTIVI 1:	28	REFLEKTIME MBI PLANET E SË ARDHMES	79
<i>Përmirësimi i funksionimit të mekanizmave për të drejtat e fëmijëve</i>			
OBJEKTIVI 2:	32	SHTOJCAT	81
<i>Avancimi i të drejtave të fëmijëve si pjesë e Agjendës</i>			
OBJEKTIVI 3:	38		
<i>Përmirësimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, për një sistem të integruar dhe efektiv të mbrojtjes së fëmijëve</i>			
OBJEKTIVI 4:	42		
<i>Përmirësimi i aksesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve</i>			
OBJEKTIVI 5:	48		
<i>Përmirësimi i aksesit dhe i cilësisë së kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (0 – 6 vjeç)</i>			
OBJEKTIVI 6:	50		
<i>Përmirësimi i cilësisë dhe i aksesit të fëmijëve në arsimin e detyruar</i>			
OBJEKTIVI 7:	53		
<i>Përmirësimi i mekanizmave për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar</i>			
OBJEKTIVI 8:	56		
<i>Përmirësimi i proceseve demokratike në shkolla</i>			
OBJEKTIVI 9:	59		
<i>Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në sistemin e drejtësisë</i>			
OBJEKTIVI 10:	63		
<i>Përmirësimi i aksesit dhe i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor për foshnjat dhe fëmijët</i>			
OBJEKTIVI 11:	66		
<i>Krijimi i mjedisit mbështetës për ofrimin e praktikave optimale të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve</i>			
OBJEKTIVI 12:	69		
<i>Përmirësimi i sistemit shëndetësor dhe i shërbimeve, që ofrohen për adoleshentët, duke i bërë ato miqësore për ta</i>			

Shkurtesa

AGJENDA	<i>Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve</i>
AKCESK	<i>Autoriteti Kombëtar për çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike</i>
AMA	<i>Autoriteti i Mediave Audiovizive</i>
AP	<i>Avokati i Popullit</i>
ASHDMF	<i>Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve</i>
BE	<i>Bashkimi Evropian</i>
CRCA	<i>Child Rights Center Albania/Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri</i>
DHS	<i>Studimi Demografik dhe Shëndetësor</i>
DRAP	<i>Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar</i>
DROSHKSH	<i>Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor</i>
EUROSTAT	<i>Statistical Office of the European Union</i>
GDMF	<i>Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”</i>
GTN	<i>Grupi Teknik Ndërsektorial</i>
IEVP	<i>Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale</i>
INSTAT	<i>Instituti i Statistikave</i>
ISHP	<i>Instituti i Shëndetit Publik</i>
IZHA	<i>Instituti i Zhvillimit të Arsimit</i>
KDIMDP	<i>Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale</i>
KIE	<i>Këshilli i Evropës</i>
KKBDF	<i>Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve</i>
KKDMF	<i>Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve</i>
KMD	<i>Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi</i>
MASR	<i>Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</i>
MSHMS	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale</i>
MB	<i>Ministria e Brendshme</i>
MBZHR	<i>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural</i>
MEPJ	<i>Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme</i>
NJMF	<i>Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve</i>
OBSh	<i>Organizata Botërore e Shëndetësisë</i>
OBSERVATORI	<i>Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve</i>
OSBE	<i>Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë</i>
OJF	<i>Organizata Jo Fitimprurëse</i>
PEI	<i>Plan Edukativ Individual</i>
PMF	<i>Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve</i>
QSUT	<i>Qendra Spitalore Universitare e Tiranës</i>
SDGS	<i>Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm</i>
SHSSH	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>
UNICEF	<i>Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët</i>
VKM	<i>Vendim i Këshillit të Ministrave</i>
ZVA	<i>Zyra Vendore Arsimore</i>

Fjala përshëndetëse



Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 shpalos përkushtimin e Qeverisë së Shqipërisë për të përmbushur të drejtat e fëmijëve në vend. Ky mision i qënësishëm merr me tepër vlera kur bëhet fjalë për fëmijët me nevoja të veçanta, që kërkojnë qasje dhe burime të dedikuara për të realizuar integrimin e tyre të plotë në shoqëri.

Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve përbën jo vetëm një detyrim ligjor

për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por, mbi të gjitha një detyrim profesional dhe etik për të paraqitur në mënyrë transparente çfarë është realizuar konkretisht në dobi të fëmijëve dhe familjeve të tyre dhe çfarë mbetet për të bërë akoma në të ardhmen.

Ashtu siç ishte praktika e hartimit të Agjendës, Raporti i ndërmjetëm / afatmesëm i monitorimit ka qenë një përpjekje e shumë institucioneve në nivel qendror dhe vendor. Në të vërtetë, këto institucione janë në kuptimin e plotë jo vetëm siguresit e informacionit, por edhe audiencia kryesore e analizave të paraqitura në këtë raport. Raporti i monitorimit afatmesëm është një pasqyrë aktuale e situatës së realizimit të masave të veprimit deri më tani për të gjitha institucionet përgjegjëse. Por synimi final mbetet përmbushja e të gjithë spektrit të masave të parashikuara në Agjendë.


Shpreh mirënjohjen time personale dhe institucionale veçanërisht për të gjithë aktorët joshtetërore, që kanë qenë pjesë integrale e zbatimit të deritanishëm të Agjendës, duke shpresuar në bashkëpunimin e tyre akoma më të ngushtë dhe të koordinuar në të ardhmen.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përtej rolit mbikqyrës dhe promovues për realizimin e të drejtave të çdo fëmije, përkushtohet të vlerësojë me përgjegjshmëri arritjet, sfidat dhe mospërbushjet e masave të veprimit nën përgjegjësinë direkte të saj apo institucioneve në varësi, siç janë paraqitur në këtë Raport. Për më tepër, në planet e së ardhmes, do të marrim në konsideratë edhe panoramën e zgjeruar të situatës së fëmijëve, paraqitur në Raportin e 5-të dhe 6-të të Shqipërisë për Komitetin e të Drejtave të Fëmijëve.

Fëmijët kanë shprehur për këtë Raport mendime për aspekte të ndryshme të jetës së tyre. Ftoj të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e realizimit të të drejtave të fëmijëve të vendosin në prioritetet e tyre pikëpamjet e fëmijëve, për të përafruar në vijueshmëri planet institucionale me nevojat reale të tyre.

Ogerta Manastirliu

Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale



Hyrje

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020 (tani e tutje referuar si Agjenda), është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 372, datë 26.04.2017. Agjenda përbën një dokument strategjik synon të arrijë mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar standartet ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë fushë dhe duke nxitur një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për të drejtat e fëmijëve.

Agjenda është hartuar nën frymën e:

- Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF);
- Rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve në Kombet e Bashkuara;
- Strategjisë së Këshillit të Evropës (KiE) për të Drejtat e Fëmijëve 2012 – 2015 dhe 2016 – 2021;
- Agjendës së Bashkimit Evropian (BE) për të Drejtat e Fëmijëve.

Agjenda përmban tri shtylla strategjike:

Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve – në këtë drejtim, Agjenda synon përforsimin e kuadrit rregullator dhe institucional, duke përfshirë mekanizmat e pavarur monitorues;

përmirësimin e monitorimit të situatës së të drejtave të fëmijëve në mënyrë që të gjenerohen të dhëna që ushqejnë politika efektive; si dhe ngritjen e mekanizmave pjesëmarrës të fëmijëve në vendim-marrje.

Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve – Agjenda synon ngritjen e një sistemi të integruar dhe efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, nëpërmjet një kuadri ligjor dhe institucional, të përmirësuar ndjeshëm.

Sisteme dhe shërbime miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve: zhvillimi, arsimimi, drejtësia, shëndeti, ushqyerja dhe mbrojtja sociale - Në këtë aspekt është synuar më së shumti, evidentimi i masave kryesore të strategjive sektoriale, për të arritur vlerësimin e progresit të të drejtave të fëmijëve në këto fusha.

Në përputhje me autoritetin që i jep Ligji 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, si edhe detyrimet e përcaktuara në Agjendë, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale (MSHMS) koordinoi procesin e monitorimit të zbatimit të Agjendës për vitet 2017-2018. Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve

(ASHDMF) mbështeti procesin e mbledhjes së të dhënave. I gjithë procesi u mbështet nga UNICEF në Shqipëri, i cili përmes Organizatës 'Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve', mundësoi ekspertizën teknike për hartimin e metodologjisë, si dhe për analizimin e informacionit që u grumbullua nga institucionet përgjegjëse. Kjo përpjekje u realizua në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas", financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Monitorimi Afatmesëm i Agjendës u krye paralelisht me një proces tjetër të rëndësishëm në fushën e të drejtave të fëmijëve, me atë të hartimit të Raportit të 5-të dhe të 6-të Periodik të Shtetit Shqiptar, drejtuar Komitetit për të Drejtat e Fëmijës. Ky proces i koordinuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) në bashkëpunim me MSHMS prodhoi një raport cilësor dhe përfaqësues, të masave të marra në vendin tonë për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijëve gjatë viteve 2012-2018, në përmbushje të KKBDF.

AGJENDA KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

Krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e shëndetshëm fizik dhe psiko-social të fëmijëve, për përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen e tyre në të gjitha proceset, nëpërmjet mbrojtjes dhe promovimit efektiv të të drejtave të fëmijëve, duke u bazuar në parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të tyre.

**MIRËQEVERISJA
NË FUNKSION
TË TË DREJTAVE
TË FËMIJËVE**

**ELIMINIMI I TË
GJITHA FORMAVE
TË DHUNËS NDAJ
FËMIJËVE**

**SISTEME DHE
SHËRBIME
MIQËSORE NDAJ
FËMIJËVE DHE
ADOLESHENTËVE**

Përmbledhje Ekzekutive


Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020 synon mbrojtjen dhe promovimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë fushë, si dhe, duke nxitur një qasje të integruar dhe gjithëpërfshirëse, për realizimin e të drejtave të tyre.

Ky raport paraqet ecurinë e zbatimit të Agjendës për periudhën 2017 –2018, duke analizuar progresin dyvjeçar të punës së institucioneve përgjegjëse dhe partnerëve të tyre, për zbatimin e masave të vendosura. Ai u hartua bazuar në të dhënat e mbledhura nga institucionet e nivelit qendror dhe vendor në të gjithë vendin, si dhe nga konsultimet me grupet e interesit, ku përfshihen edhe shoqëria civile dhe grupet e fëmijëve.

Agjenda përmbledh një total prej 265 masash dhe 75 treguesish të rezultateve, që janë parashikuar për realizimin e 14 objektivave, të ndara sipas tri shtyllave strategjike.


Institucionet kanë raportuar progresin në realizimin e **treguesve të rezultatit**, siç paraqiten edhe në mënyrë të përmbledhur në grafikun 1.

GRAFIKU 1. STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATEVE (NË %)




Të dhënat e grumbulluara nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror e vendor japin informacion për 231 prej 265 masave të parashikuara në Agjendë, sipas ndarjes së treguar në grafikun 2

GRAFIKU 2. NIVELI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË %)



Ecuria e progresit të **masave të raportuara** shprehet si më poshtë në grafikon 3.

GRAFIKU 3. STATUSI I REALIZIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (NË %)



Gjatë raportimit shprehet nevoja e rishikimit të disa prej masave dhe treguesve. Gjithashtu ka paqartësi nëse masat e përealizuara duhet të shtyhen për periudhën, që mbetet për zbatimin e Agjendës, duke rishikuar afatet e tyre kohore, apo duhet të vlerësohet mundësia e heqjes së tyre dhe zëvendësimit me masa të reja.

Progresi i raportuar nën **Shtyllën I strategjike** shënon zbatimin e disa nismave të rëndësishme në përmirësimin e kuadrit ligjor për të drejtat e fëmijëve. Këtu përfshihen miratimi i ligjit të ri "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve", "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" dhe përmirësimet e paketave të tjera ligjore, të cilat sjellin ndryshime pozitive për të gjithë fëmijët në Republikën e Shqipërisë.

Kuvendi i Shqipërisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në avancimin e të drejtave të fëmijëve

dhe fuqizimin e qeverisjes me fokus fëmijët, duke riaktivizuar grupin e deputetëve "Miq të fëmijëve". Institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, përfshirë edhe ato të fëmijëve (Avokati i Popullit (AP), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP)), kanë demonstruar rritje profesionale dhe kanë intensifikuar veprimtarinë e tyre me fokus fëmijët.

Është përfunduar Raporti i 5të dhe i 6të i Shtetit për Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, në zbatim të KKBDF dhe protokolleve të tij opsionale për periudhën kohore 2012-2018.

Nisma dhe iniciativa janë shënuar edhe në kuadër të përmirësimit të disponueshmërisë dhe publikimit të të dhënave të lidhura me fëmijët, si: ngritja e Prototipit të Sistemit të Integruar të të Dhënave për Drejtësinë për të Miturit, Sistemit të Mbledhjes së të Dhënave për Monitorimin e Rritjes dhe Praktikave të Ushqyerjes së Fëmijëve; si edhe publikimi i 'Studimit Demografik dhe Shëndetësor për Shqipërinë 2017-2018'.

Gjithsesi, kanë mbetur të përealizuara vlerësime të rëndësishme lidhur me ndikimin e legjislatcionit të rishikuar tek fëmijët, si edhe të komponentit të buxhetimit me fokus fëmijët. I përealizuar ka mbetur statusi i aktiviteteve me fokus pjesëmarrjen e fëmijëve, ndryshimin e normave sociale, forcimin e kapaciteteve për promovim, respektim, monitorim e raportim të të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.

Nën **Shtyllën II strategjike** raportohet miratimi i akteve nënligjore në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve, si edhe përfundimi i projektvendimeve të tjera për t'u miratuar në vijim. Mbetet për t'u kryer në vijim rishikimi tërësor i kuadrit ligjor për t'u harmonizuar me ndryshimet e fundit ligjore në funksion të mbrojtjes së fëmijëve.

Dokumentohet progres në ngritjen e strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, duke e çuar në 235 numrin e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në të gjithë vendin. Gjithsesi, ky numër nuk përfaqëson ngritjen e të gjitha strukturave të nevojshme në përputhje me përcaktimet ligjore. Sfidë në kryerjen e funksioneve mbetet zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të të gjithë profesionistëve të përfshirë, buxheti për manaxhim i rasteve në nivel vendor, monitorimi mbështetës, si edhe inspektimi bazuar në standarde të përditësuara.

Është hartuar "Plani Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge, 2019-2020", si edhe projektvendimi, që do të orientojë profesionistët në manaxhimin e këtyre rasteve.

Progres është shënuar në fushën e mbrojtjes së fëmijëve online. Paralelisht me analizën e kuadrit ligjor, institucional dhe kapaciteteve në fushën e sigurisë online të fëmijëve janë mbledhur të dhëna mbi përvojat e fëmijëve dhe prindërve online; prej nga do të bazohet identifikimi i masave të mëtejshme në këtë fushë. Në mbështetje të planit të veprimit është hartuar edhe projektvendimi mbi

"Masat për Mbrojtjen e Fëmijëve nga aksesi në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet". Ndërgjegjësimi i fëmijëve është mundësuar përmes programit të edukatorëve/këshilluesve fëmijë mbi sigurinë online.

Në mbështetje të raportimit të rasteve të dhunës dhe keqtrajtimit të fëmijëve është realizuar tranzicioni i mbështetjes së platformës telefonike ALO 116 nga burimet financiare të UNICEF tek ato të Qeverisë/MSHMS.

Përpos funksionimit të rregullt të Komisioneve të Etikës dhe Disiplinës për raportimin e dhunës nga ana e fëmijëve është hartuar plani i veprimit dhe është ndërmarrë trajnimi i stafëve arsimore për të mundësuar një mjedis pa dhunë në shkolla.

Me fondet e qeverisë është ngritur dhe inauguruar pranë mjediseve të Qendrës Spitalore "Nënë Tereza" (QSUT) në Tiranë qendra LILIUM, e cila ofron shërbime të specializuara për fëmijët, që kanë rënë pre e abuzimit seksual, apo formave të tjera të rënda të dhunës.

Qasja ndërsektoriale për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit është përforcuar nga miratimi/rishikimi i procedurave standarde të veprimit, duke mundësuar mbrojtjen e të paktën 94 fëmijëve gjatë këtyre dy viteve të raportimit.

Nën **Shtyllën III strategjike**, progres është shënuar në fushën e arsimit dhe zhvillimit të fëmijëve. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) ka ndërmarrë hartimin e disa dokumenteve

rregullatorë, ku gjejnë hapësirë konceptet e edukimit bazuar në kompetenca, duke u ndërthurur me elementë të të drejtave, barazisë gjinore dhe mos-diskriminimit, si për shembull: ‘Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor’; ‘Programet e arsimit parashkollor për moshën 3 dhe 4- vjeçare’. Mbeten në fokus të vëmendjes masat lidhur me regjistrimin e fëmijëve 5 dhe 6- vjeçarë në kopshte apo klasa përgatitore.

Nënshkrimi i marrëveshjes tri-palëshe, mes Ministrisë së Brendshme (MB), MSHMS dhe MASR “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”, rikonfirmon angazhimin e institucioneve në nivel qendror, për të identifikuar dhe për t’i dhënë zgjidhje rasteve të fëmijëve jashtë sistemit shkollor. Duhet përmendur se, zbatimi në praktikë i marrëveshjes ka rezultuar të jetë relativisht i vështirë, si në aspektin e bashkëpunimit ndër-institucional, ashtu edhe për të bindur familjet dhe fëmijët të rikthehen në shkollë.

Tashmë ka filluar zbatimi i masave të planifikuara në kuadër të ‘Planit të Veprimit për Arsimin Gjithëpërfshirës’, me fokus të veçantë fëmijët me aftësi të kufizuara. Një tjetër plan veprimi i targeton fëmijët me shtetësi të huaj, me qëllim lehtësimin e integritit të tyre në institucionet arsimore para-universitare.

Me hartimin dhe zbatimin e standardeve për Shkollat si Qendra Komunitare janë rritur mundësitë për pjesëmarrje më të gjerë të grupeve të interesit në strukturat qeverisëse të shkollës, veçanërisht

për fëmijët dhe prindërit. Por këto mekanizma, ndonëse me role dhe detyra të përcaktuara mirë, hasin ende në sfida për të realizuar qëllimin për të cilin janë ngritur.

Në Fushën e Drejtësisë, miratimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit shënon dokumentin e parë politik të masave të Qeverisë Shqiptare, në fushën e drejtësisë për të miturit. Kjo strategji, së bashku me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit dhe legjislacionin sekondar mbështetës është në koherencë me KKBDF, si dhe me standarde të tjera ndërkombëtare. Konceptet, parimet dhe mekanizmat e rinj ligjorë, që ka parashikuar Kodi, përbëjnë risi, por në të njëjtën kohë sfida për të gjithë profesionistët e fushës së drejtësisë për të miturit. Edhe pse ka nisur trajnimi i profesionistëve të fushës mbi ndryshimet ligjore, më tepër mbetet për t’u bërë në të ardhmen në këtë drejtim.

Ende pritet riorganizimi i gjykatave dhe prokurorive, që të mundësohet krijimi i seksioneve për fëmijët në ato rrethe gjyqësore, ku këto seksione nuk janë ngritur, përveç 7 të tillave, që funksionojnë tashmë.

Në Fushën e Shëndetësisë dhe Ushqyerjes, treguesit e matur shënojnë një ecuri pozitive në sektorin e shëndetësisë. Aktualisht MSHMS është në proces rishikimi dhe përditësimi të standardeve të kujdesit shëndetësor parësor, punë, e cila pritet të përfundojë gjatë vitit 2019. Janë hartuar protokollat për ndjekjen e shëndetit amtar dhe të të porsalindurit në situatat e emergjencave civile. “Studimi Demografik dhe Shëndetësor për Shqipërinë (DHS) 2017-2018” prezanton të dhëna

të një game të gjerë, i cili do të mundësojë matjen e progresit në disa fusha dhe njëkohësisht, do të ofrojë të dhëna të nevojshme për të raportuar progresin e Shtetit Shqiptar në përmbushje të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs).

Komiteti Kombëtar për Çrregullimet e Pamjaftueshmërisë Jodike, i ngritur si grup ekspertësh pune në 2018, ka propozuar ndryshimet ligjore për të përmirësuar monitorimin dhe inspektimin e kontrollit të kripës së jodizuar.

Një grup tjetër ndërsektorial pune është ngritur për të hartuar Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Shëndetin dhe Mirëqënien e Fëmijëve dhe Adoloshentëve.

Në fushën e mbrojtjes sociale, pritet të vlerësohet ndikimi i skemës së ndihmës ekonomike tek grupet në nevojë, në shkallë vendi. Gjatë 2018 ka filluar procesi i hartimit të projektligjit "Për mbrojtjen sociale," i cili synon të rregullojë mënyrën e shpërndarjes së ndihmës ekonomike, të pagesave të aftësisë së kufizuar dhe të bonusit të bebeve, për të garantuar mbrojtje sociale për të gjithë qytetarët, veçanërisht për familjet dhe individët në nevojë.

Ka nisur tashme zbatimin i VKM për mbështetjen financiare të familjeve që lindin fëmijë, për të mundësuar në mënyrë të menjëhershme përmbushjen e nevojave të të porsalindurve.

Legjislacioni mbi Shërbimet e Kujdesit Shoqëror dhe Ndërmarrjeve Sociale është pasuruar me vendimet shoqëruese, për të lehtësuar zbatimin

e tyre në nivel vendor. Gjithsesi, financimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror mbetet ende sfidë për pushtetin vendor, i cili ka detyrimin të planifikojë dhe ofrojë shërbime për grupet e identifikuara në nevojë. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale Shtetërore raporton se në krahasim me vitin 2016 janë ngritur 10 shërbime të reja me fokus fëmijët.

Procesi i hartimit të metodologjisë dhe vetë planeve sociale ka qenë gjithëpërfshirës. Hartimi i tyre ka përfshirë përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, që kanë rol në garantimin e mbrojtjes sociale, përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve. Ky proces pati edhe mbështetjen teknike të organizatave ndërkombëtare. 16 Bashki, raportojnë se e kanë hartuar planin e tyre social, por jo të gjitha planet janë ende të buxhetuara, çka mund të rrezikojë realizimin e objektivave të tyre.

Së fundmi, MSHMS ka prezantuar dhe një plan kombëtar për de-institucionalizimin e fëmijëve në qendrat e kujdesit rezidencial. Në të njëjtën kohë ka nisur edhe procesi i vlerësimit të rasteve të çdo fëmije dhe situatës së kapaciteteve të familjeve biologjike, për ri-integrimin e fëmijëve në familjet e tyre.

Përsa i përket **parashikimeve financiare/ buxhetore,** raporti analizon shpenzimet faktike të periudhës 2017-2018, të kryera në funksion të zbatimit të planit të veprimit të Agjendës. Raporti tenton të analizojë lidhjen, që ekziston mes parashikimit të shpenzimeve buxhetore të planit të veprimit dhe shpenzimeve faktike të kryera nga burimet e ndryshme të financimit. Raporti tregon që nuk ka një lidhje të fortë midis masave të

parashikuara në planin e veprimit dhe planifikimit të shpenzimeve buxhetore. Disa përfundime të tjera, që dalin nga kjo analizë janë:

- Sipas raportimeve, për periudhën 2017-2018, shpenzimet faktike për zbatimin e planit të veprimit, në ato masa veprimi që janë të buxhetura, kapin shifrën e rreth 222 milionë lekëve.
- 61.0% e shpenzimeve faktike, që raportohen janë mbuluar nga fonde të buxhetit të shtetit dhe 39.0% nga fonde të donatorëve.
- Shpenzimet faktike të realizuara dhe raportuara për periudhën 2017-2018 janë sa 9.4% e shpenzimeve totale të planifikuara për zbatimin e planit të veprimit për periudhën 2017-2020.
- Shpenzimet faktike të mbuluara nga buxheti i shtetit, për zbatimin e veprimtarive të periudhës 2017-2018 janë sa 8.9% e shpenzimeve totale të planifikuara për t'u mbuluar nga buxheti i shtetit, për zbatimin e masave të Agjendës.
- Realizimi i shpenzimeve ndryshon sipas objektivave. Për 3 objektiva të planit të veprimit, shpenzimet faktike të raportuara janë realizuar në masën nga 31.0% deri në 50.0%; për 3 objektiva të tjerë në masën nga 11.0% deri në 30.0% dhe për 7 objektiva realizimi i shpenzimeve është nën 10.0%.

- Në disa raste janë vërejtur mospërputhje midis statusit të progresit të një mase të caktuar dhe raportimit të shpenzimeve faktike, ose janë raportuar shpenzime faktike më të larta sesa kostoja e parashikuar për zbatimin e masës përkatëse.

Përtej raportimit mbi zbatimin e Agjendës për vitet 2017-2018, u tentua të mblidhej informacion nga institucionet edhe mbi planet e masave të veprimit për 2019-2020. Nga pjesa më e madhe e institucioneve nuk u arrit të mblidhej informacioni i nevojshëm për të dalë në një përfundim të shkallës së ndryshimeve të pritshme. Gjithsesi, disa faktorë duhet të merren parasysh për të vendosur mbi ndryshimet apo vetë modalitetin e ndryshimeve të masave për vitet e ardhshme. Disa nga këta faktorë janë: numri i konsiderueshëm i masave të alternuara/shtyra/mosrealizuara të Agjendës derimëtani; përditësimi rrënjësor i kuadrit ligjor/rregullator në fushën e mbrojtjes shoqërore dhe mbrojtjes së fëmijëve; i ndryshimeve të strukturave institucionale në nivel qendror prej vitit 2017; i roleve dhe përgjegjësive të reja të pushtetit vendor; i gjetjeve nga raporti periodik i Shtetit për Komitetin për të Drejtat e Fëmijëve; i boshllëkut institucional për koordinimin e fushave si Fëmijëria e Hershme (kryesisht 0-3 vjeç), monitorimin dhe inspektimin e standardeve për lundrimin e sigurtë të fëmijëve në internet, etj.

Metodologjia

Raporti i monitorimit afatmesëm të Agjendës prezanton një analizë të rezultateve të arritura dhe shpenzimeve financiare të realizuara, për periudhën 2017 – 2018. Raporti paraqet një pasqyrë të progresit të deritanishëm, si edhe tendencën për zbatimin dhe arritjen e objektivave të vendosur, deri në fund të periudhës strategjike.

Në përgjigje të detyrimit për monitorim dhe raportim afatmesëm të Agjendës, MSHMS e mbështetur nga UNICEF në Shqipëri, ndërmori hapat e mëposhtëm për të realizuar hartimin e këtij raporti:

- Hartimin prej një grupi teknik, me përfaqësues të MSHMS, ASHDMF, UNICEF, Observatorit dhe ekspertë të pavarur, të metodologjisë dhe instrumenteve për mbledhjen e informacionit.
- U hartuan rreth 40 instrumente, të përshtatura për secilin institucion raportues (20 për masat dhe 20 për treguesit), për të mbledhur informacion të detajuar për çdo masë dhe çdo tregues rezultati të Agjendës, duke përfshirë edhe të dhëna buxhetore për periudhën 2017-2018.
- Prezantimin dhe diskutimin e instrumenteve në 7 takime të organizuara për këtë qëllim, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve

raportuese të nivelit qendror dhe vendor, si dhe Organizatat Jo Fitim prurëse (OJF), të cilat kishin shprehur interes për t'u përfshirë në këtë proces. Fokusi i takimeve u zgjodh të jetë në përputhje me fushat kryesore të veprimit të Agjendës.

- Konsultimin me grupe fëmijësh.

Pas grumbullimit të informacionit fillestar, në një fazë të dytë, institucioneve ju dha koha e nevojshme të rishikojnë, përmirësojnë e plotësojnë informacionin e raportuar. Në total, 12 institucione përgjegjëse në nivel qendror dhe 24 Bashki dorëzuan informacionin, mbi të cilin u hartua ky Raport (Shtojca 1).

Në ndihmë të informacionit të raportuar nga institucionet qeveritare u mblodh informacion edhe nga 5 OJF, i cili fokusohet në kontributet e tyre për zbatimin e masave të Agjendës. Ky informacion u vlerësua dhe u dakordësua me institucionin përgjegjës për hartimin e këtij raporti.

Afatet kohore të këtij procesi përmbledhën periudhën nëntor 2018 – maj 2019. Në mënyrë më të detajuar, procesi kaloi në etapat e mëposhtme:

Nëntor 2018	Dhjetor 2018–Janar 2019	Shkurt-Mars 2019	Mars -Prill 2019	Maj 2019
<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i metodologjisë dhe i instrumenteve të mbledhjes së informacionit Konsultimi me fëmijët Takim prezantues për procesin e raportimit (Ministritë e Linjës) dhe dakordësimi mbi metodologjinë 	<ul style="list-style-type: none"> Grumbullimi i gjithë informacionit. Workshope në nivel teknik me institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile për të validuar instrumentet 	<ul style="list-style-type: none"> Hartimi i Raportit 	<ul style="list-style-type: none"> Plotësimi i raportit me informacionet e munguara – raundi i dytë i mbledhjes së informacionit 	<ul style="list-style-type: none"> Përfundimi i Raportit

MBLEDHJA E INFORMACIONIT PËR REALIZIMIN E MASAVE TË VEPRIMIT TË AGJENDËS

Për të raportuar mbi zbatimin e masave të parashikuara në Agjendë u hartua një model instrumenti, i cili identifikon të gjitha aktivitetet e planifikuara për vitet 2017-2018. Për secilin aktivitet, instrumenti u kërkon institucioneve të raportojnë statusin e realizimit/zbatimit të aktivitetit, çfarë është realizuar konkretisht, sfidat dhe problematikat e ndeshura gjatë zbatimit, aktorët e përfshirë në zbatim, sugjerime konkrete për rishikimin e planit të aktiviteve apo për zëvendësimin e aktiviteve të veçanta me ndërhyrje të reja aty ku është e nevojshme, si edhe informacion mbi shpenzimet e kryera. Instrumentet u përshtatën për secilin institucion, që parashikohet të ketë një rol udhëheqës ose bashkëveprues, gjatë zbatimit të Agjendës.

U kërkua që statusi/progresi i realizimit dhe zbatimit të aktiviteve të raportohet sipas disa kategorive të sqaruara në tabelë. Kjo, për të siguruar një harmonizim midis raportimit narrativ të veprimtarisë dhe vlerësimit të progresit në zbatimin e aktivitetit prej institucionit raportues:

LEGJENDA E RAPORTIMIT TË REALIZIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT

Statusi	Shpjegimi
Realizim	Aktiviteti ka përparuar sipas parashikimeve (rezultate dhe afate kohore).
Progres	Zbatimi i aktivitetit ka filluar, por nuk ka përparuar sipas planit (rezultate dhe/apo afate kohore).
Alternim	Aktiviteti ka pësuar ndryshime apo shtesa nga parashikimi/ Zbatimi i aktivitetit të ri ka filluar apo ka përfunduar.
Shtyrje	Zbatimi i aktivitetit është shtyrë, por mbetet i rëndësishëm.
Mosrealizim	Aktiviteti nuk do të ndërmerret.

Pjesa e dytë e instrumentit mbledhi informacion mbi planet në vijim, gjatë viteve 2019 – 2020. Kjo pjesë e instrumentit synon mbledhjen e sugjerimeve dhe mendimeve për ndryshime të mundshme nga parashikimi, qoftë në nivel aktivitetesh (ndryshim, pezullim apo zëvendësim me një aktivitet të ri), në nivel treguesish, apo edhe ndryshime të mundshme në lidhje me vetë institucionet përgjegjëse për zbatimin e tyre e të partnerëve që duhet të angazhohen, qofshin këta publikë ose jo.

Në fund të çdo objekti, institucionet kishin lirinë të sugjeronin aktivitete të reja të paplanifikuara apo të pamenduara në kohën kur u hartua Agjenda por, të cilat konsiderohen tashmë si të rëndësishme.

Mangësitë dhe sfidat e identifikuar

- Agjenda është miratuar në Prill 2017, por sidoqoftë ajo përfshin veprimtari që duhet të zbatoheshin në periudhën 2016-2017, periudhë, e cila u la jashtë fokusit të këtij monitorimi afatmesëm.
- Niveli i raportimit nga institucionet, që kanë rol dhe përgjegjësi për zbatimin e masave të parashikuara, si në nivel qendror edhe në atë vendor, nuk ishte në masën 100%. Kjo ndikoi pasqyrimin e progresit real të disa prej masave, si dhe të shtrirjes gjeografike të zbatimit të tyre. Nga 81 institucione të kontaktuar (20 në nivel qendror dhe 61 Bashki) vetëm 39 prej tyre dorëzuan informacionin e kërkuar (12 në nivel qendror dhe 27 Bashki).
- Jo të gjitha institucionet raportuese dhanë informacion të plotë sipas rubrikave të instrumentit. Ndonëse instrumenti iu rikthye shumicës së tyre, për të marrë informacion shtesë në rubrikat e paplotësuara, një gjë e tillë nuk ndodhi në të gjitha rastet. Kjo ka ndikuar që informacioni i përfshirë në raport, të mos prezantojë pamjen e plotë dhe të saktë të situatës. Siç pasqyrohet edhe në kapitujt e këtij raporti, në disa prej masave mungon informacioni për statusin e progresit të tyre. Për pasojë, dokumentimi i progresit është kufizuar vetëm tek masat për të cilat u mbledh informacion dhe mund të kryhej analiza e tij.
- Nga informacioni i mbledhur, mbetet e paqartë vijimësia e zbatimit të masave të përcaktuara gjatë periudhës 2017 – 2018. Është vështirë të gjykojmë nëse zbatimi i këtyre masave vijon të jetë prioritet për periudhën e mbetur 2019 –

2020, apo ka pamundësi reale për t'i zbatuar ato. Planet për 2019 – 2020 mbeten të pandryshuara, edhe pse zbatimi i tyre lidhet ngushtësisht me buxhetin e dedikuar për këtë periudhë.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT MBI TREGUESIT E REZULTATIT

Agjenda përmban 75 tregues rezultati, që janë paraqitur si në tabelën përmbledhëse të treguesve, ashtu edhe në tabelën e aktiviteteve. Treguesit janë të profilit ndërsektorial, pra tregues të përbërë, për të cilët kërkohet raportimi i disa ministrive apo institucioneve dhe tregues të thjeshtë, pra sektorialë ku kërkohet raportimi i një sektori.

Për të mbledhur informacion mbi progresin e arritur të treguesve u hartuan instrumente të dedikuara për secilin institucion përgjegjës për të raportuar. Instrumentet, përpos kërkesës për të dhënë informacion për vlerën numerike dhe statistikore, apo shpjegim narrativ, kërkojnë informacion të klasifikuar si në tabelën e mëposhtme:

LEGJENDA E RAPORTIMIT TË REALIZIMIT TË TREGUESVE TË REZULTATIT

Statusi	Shpjegimi
I arritur	Targeti i synuar është arritur.
Pjesërisht i arritur	Arritja e targetit kundrejt atij të synuar është në proces - shpjegoni më tej në kolonën e komenteve.
I paarritur	Targeti nuk është arritur - shpjegoni më tej në kolonën e komenteve, arsyet e mos arritjes.
I pamatur	Në rastet kur kanë munguar të dhënat për matjen e treguesit, shënohet "I pa matur" dhe në kolonën e komenteve, qartësohen arsyet e mosmatjes së treguesit.

Përpunimi i informacionit të mbledhur u mbështet në vlerësimin dhe krahasimin e tij përkundrejt matjeve fillestare (baseline) të kryera në fazën e hartimit të

Agjendës, përkundrajt synimit afatmesëm, si dhe atij afatgjatë, i cili përkon me vitin 2020. Në rastet kur këto informacione kanë munguar, përfundimet janë bazuar tek informacioni i mbledhur në tërësi.

Mangësitë dhe sfidat e identifikuara

Agjenda përmban 75 tregues, prej të cilëve:

- 71% e treguesve nuk përmbajnë informacion për matjet fillestare;
- 76% e treguesve nuk kanë synim afatmesëm të përcaktuar;
- 12% e treguesve nuk kanë synim afatgjatë të përcaktuar;
- Praktikisht, 81% e treguesve nuk kanë të paktën një nga vlerat, matjen fillestare apo targetin e synuar;
- Për 19%¹ të treguesve, ose është propozuar ndryshimi i tyre, ose janë të pamatshëm dhe për pasojë ka patur sfida në raportimin e tyre për këtë raport.

MBLEDHJA E INFORMACIONIT PËR SHPENZIMET FINANCIARE

Nëpërmjet këtij instrumenti raportohen burimet financiare dhe sasia e vënë në dispozicion për zbatimin e planit të veprimit të Agjendës. Instrumenti kërkon të raportohet për shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike² për periudhën 2017-

1. Kjo vlerë nuk bie në kontrast me atë të raportuar më parë tek Përmbledhja Ekzekutive, ku thuhet se 7% e treguesve janë raportuar nga institucionet si të pamatur. Vlera 19% përfshin edhe treguesit për të cilët janë raportuar, por institucionet raportojnë të kenë patur vështirësi në raportim dhe propozojnë ndryshime për të ardhmen.

2. Shpenzime faktike -shuma totale e parave që institucionet qëndrore, institucionet e pavarura dhe Bashkitë kanë shpenzuar në një vit financiar (p.sh. Janar-Dhjetor 2017) për zbatimin e Agjendës

2018, në funksion të zbatimit të çdo veprimtarie, si dhe kërkon informacion për burimet e financimit. Të dhënat janë grumbulluar nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave të Agjendës. Mbështetur në planin e veprimit dhe në të dhënat e grumbulluara prej institucioneve përgjegjëse, Bashkive dhe OJF-ve, janë evidentuar:

- numri i masave të buxhetuara;
- numri i masave të pa buxhetuara.

Informacioni i grumbulluar për *masat e buxhetuara* është klasifikuar në tre grupe:

- masa të raportuara plotësisht;
- masa të raportuara pjesërisht;
- masa të pa raportuara.

Informacioni i grumbulluar për shpenzimet faktike për *masat e raportuara*, plotësisht apo pjesërisht, është prezantuar në këtë raport si më poshtë:

- Shpenzime faktike për realizimin e secilit objektiv, të kryera nga të gjitha burimet e financimit;
- Realizimi i shpenzimeve kundrejt shpenzimeve të planifikuara për secilin objektiv dhe fushë të strategjisë;
- Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit (buxheti i shtetit apo financime të donatorëve).

Në pak raste, institucionet kanë raportuar shpenzime faktike nën disa masa, për të cilat raportohet se nuk janë realizuar, se kanë shtyrë afatin e realizimit apo, për të cilat nuk ka fare informacion. Këto shpenzime nuk reflektohen në përlllogaritjet e kryera në këtë raport.

Mangësitë dhe sfidat e identifikuara

- Buxheti i nevojshëm për zbatimin e planit të veprimit nuk është zbërthyer për çdo vit buxhetor, por shifrat janë parashikime, që mbulojnë të gjithë periudhën e zbatimit. Kjo mënyrë paraqitjeje, u krijon vështirësi institucioneve përgjegjëse dhe grupeve të interesit të monitorojnë vit pas viti shpenzimet e planifikuara dhe ato faktike.
- Agjenda është miratuar me VKM nr. 372, datë 26.04.2017. Në planin e veprimit të Agjendës janë përfshirë gjithashtu dhe veprimtari që duhet të zbatoheshin në vitin 2016. Raporti pasqyron informacion për shpenzimet e planifikuara dhe shpenzimet faktike vetëm për periudhën 2017-2018, pasi vetëm për këtë periudhë mund të krahasonim planin me faktin.
- Në Planin e Veprimit të Agjendës janë 41 masa, ose 15.5% e numrit të përgjithshëm të tyre, për të cilat nuk është planifikuar buxhet. Për këto masa është e vështirë të identifikohet kostoja, pasi kjo do të kërkonte një analizë të re, të bazuar në targetet e planifikuara. Numri më i madh i masave të pa buxhetuara, kundrejt numrit të përgjithshëm të masave, i përket objektivit 4 me 46.6% të tilla dhe objektivit 8 me 57.1% të tilla.
- Për 181 masa ose 80.8% të tyre, institucionet nuk kanë përcjellë informacion për shpenzimet faktike.
- Për 20 masa të buxhetuara ose 8.9% të tyre, institucionet kanë raportuar shpenzime faktike më të mëdha sesa kostoja e planifikuar. Në disa raste, niveli i shpenzimeve, që është raportuar nuk lidhet me shpenzimet për

zbatimin e veprimtarisë së parashikuar në planin e veprimit, por me shpenzimin në total që bën institucioni për produktin, ku është përfshirë masa përkatëse. Në këto raste krijohet perceptimi sikur janë shpenzuar më shumë fonde sesa planifikimi. Rastet e tjera janë të lidhura me shpenzime faktike të raportuara nga OJF-të dhe donatorët, ku shpenzimet faktike e tejkalojnë koston e planifikuar gjatë hartimit të planit.

- Institucionet nuk kanë dhënë informacion mbi parashikimet buxhetore për zbatimin e masave të planifikuara për periudhën 2019-2020. Parashikime buxhetore janë raportuar vetëm për 26 masa të buxhetuara ose 11.6% të tyre. Këto lloje të dhënash janë ofruar kryesisht nga donatorët, nga disa Bashki dhe nga OJF-të. Ky nivel informacioni lë vend për dyshime, që raporti përfundimtar i zbatimit të Agjendës në fund të vitit 2020 mund të shfaqë të njëjtat problematika në raportimin buxhetor.

KONSULTIMI ME FËMIJËT

Konsultimi me fëmijët u krye për të mbledhur mendimet e tyre, për tematikat dhe çështjet e përfshira në Agjendë, por edhe për më shumë se kaq. U organizuan 6 takime konsultuese gjithsej, në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Korçës dhe Peshkopisë, ku morën pjesë 106 fëmijë (prej tyre 56 vajza) të moshës shkollore, 11 deri në 18 vjeç. Dy nga këto takime konsultuese u zhvilluan me pjesëmarrjen e 23 fëmijëve me aftësi të kufizuara si dhe me pjesëmarrjen e 7 fëmijëve të një institucioni rezidencial.

Metodologjia e ndjekur për konsultimin me fëmijët u dakordësua me grupin teknik të ngritur për hartimin e këtij raporti. Gjithashtu, vlerësimi i çështjeve etike të metodologjisë u krye nga një bord me ekspertë të fushës së kërkimit shkencor dhe të etikës, që u formua nga UNICEF. Për të gjithë fëmijët

e përfshirë në konsultime u kërkua paraprakisht leja e kujdestarëve ligjorë dhe procesi i konsultimit u krye nga lehtësues të trajnuar. Përtej mendimeve të fëmijëve, metodologjia synoi edhe mbledhjen e materialeve vizuale të përgatitura prej tyre, të cilat janë përdorur si ilustrime përgjatë këtij raporti.



Foto kredit: Beci/UNICEF/Albania

Zëri i fëmijëve

Fëmijët e përfshirë në konsultime dhanë mendimet e tyre për një sërë tematikash, që i shqetësojnë ata. Në këtë kapitull, mendimet e tyre janë paraqitur, duke u bazuar në parimin e thjeshtë të renditjes të temave, nga ato të përgjithshme në ato më specifike.

Fëmijët shprehën rëndësinë e të qenit të informuar gjerësisht, për dokumentet strategjike, që janë hartuar për të promovuar dhe garantuar të drejtat e tyre. Ata shprehën se, dokumente të rëndësishme, si Ligji për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, apo roli dhe detyrat e institucioneve që realizojnë të drejtat e tyre, duhet të njihen mirë nga të rriturit e çdo sektori. Kjo njohuri duhet të shtrihet edhe tek fëmijët, përmes kurrikulës me zgjedhje që zbatohet në institucionet arsimore. Një gjë e tillë do të siguronte njohje më të thelluar nga ana e fëmijëve, për çfarë parashikon paketa e ligjeve dhe politikave për të drejtat e tyre, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion. Për rrjedhojë fëmijët do të jenë më tepër të sensibilizuar dhe të ndërgjegjësuar për të drejtat që gëzojnë, si dhe për mënyrat e raportimit në rastet kur ato ju cënohen.

Vërehet një hezitim nga ana e fëmijëve për të pranuar se e drejta e tyre për pjesëmarrje është

një realitet dhe jo tokenizëm. Pavarësisht se vihen në zbatim procese, që kërkojnë mendimin dhe opinionin e fëmijëve, ata raportojnë se të rriturit janë rezistues për të marrë në konsideratë mendimin e tyre dhe akoma shumë larg zbatimit të propozimeve të tyre.

“Ambicia e fëmijëve për të ngritur zërin, përkon me frikën e mospranimin të mendimit të tyre nga të rriturit.”

“Është sistematike mosmarrja seriozitet e punës së fëmijëve nga më të rriturit, duke i paragjykuar ata.”

Mekanizmat si Qeveritë e Nxënësve, që sigurojnë të drejtën e fëmijëve për pjesëmarrje dhe për të ndikuar vendimet që i prekin ata brenda shkollës, ndonëse kanë role dhe detyra të përcaktuara mirë, si edhe qartësi në procesin e zgjedhjes së anëtarëve të tyre, hasin ende në sfida për të realizuar qëllimin për të cilin janë ngritur. Fëmijët mendojnë se ka ende shumë për të bërë, për t'i fuqizuar dhe për t'i bërë funksionale këto struktura, që të mund të përcjellin mendimet e të gjithë fëmijëve në proceset vendimmarrëse të shkollës.

“Fëmijët, që marrin pjesë në aktivitete janë vetëm ata fëmijë, që kanë rezultate të larta në mësim. Të tjerët mbeten mënjanë, nuk përfshihen.”

“Ata të Qeverisë së Nxënësve marrin pjesë gjithmonë nëpër aktivitete. Duhet të ketë më shumë aktivitete, ku të marrin pjesë të gjithë nxënësit.”

Prania e formave të ndryshme të dhunës raportohet nga fëmijët si një çështje, që kërkon vëmendje të veçantë. Fëmijët ngrenë shqetësime reale, që duhet të analizohen dhe të adresohen në mënyrën e duhur, jo vetëm nga profesionistët brenda shkollës, si mësuesit e psikologët, por edhe nga struktura të tjera, si Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) apo ofruesit e shërbimeve të specializuara.

“Ka bulizëm në shkolla dhe ka gjithmonë hierarki në shkollë – ‘të fortët’ dhe ‘të dobët’ e shkollës. Aktivitetet sportive mund të jenë pikërisht ato, që i bashkojnë të fortë e të dobët, duke krijuar klimë miqësore. Organizimi i aktiviteteve mund të bëhet nga vetë nxënësit dhe mësuesit, për të krijuar besim reciprok.”

“Fëmijët vetë bëjnë bulizëm, duke thënë: ‘e sheh atë si është kështu apo ashtu’. Por ka shumë raste që zysha i ndan disa nga të tjerët. Thonë ky dhe ky dhe ky do e bëjnë këtë detyrë, se janë perfektë. Ju të tjerët nuk dini.”

Fëmijët shprehin nevojën për të adresuar më fuqishëm dhunën ndaj tyre dhe fenomenin e

bulizmit, i cili është aktualisht shqetësues, për shumicën e fëmijëve të përfshirë në procesin e konsultimit.

Rastet e bulizmit nuk vihen re nga mësuesit, se vetë fëmijët i fshehin ato, por ajo që shikojmë ne në shkollë është shumë më e ndryshme nga ajo që shikojnë të rriturit dhe mësuesit. Është e vështirë që të rriturit të shikojnë të njëjtën tablo si ne fëmijët, pasi janë vetë fëmijët që e fshehin atë, ndaj duhet bërë diçka ndryshe.”

Fëmijët janë të ndjeshëm edhe për forma të tjera të dhunës:

Edhe për sigurinë në internet duhet bërë diçka, se aty mund të të ngacmojnë edhe më shumë se në shkollë.”

Forcimin e mekanizmave në funksion të respektimit të të drejtave të fëmijëve, ata e shohin të lidhur me aftësimin e të rriturve për t’u përballur dhe për t’i adresuar rastet.

Kërkojmë mësues të përgatitur për menaxhimin e rasteve të bulizmit mes nxënësve. Ata duhet të dinë sesi ta shmangin konfliktin dhe ta kthejnë atë në një çështje debati e reflektimi, gjë, e cila do të ndihmonte që ky moment i vështirë të kalohej më lehtë.”

Të rriturit e shikojnë veten të rritur dhe ne gjithmonë si fëmijë. Ndiejmë diçka si akull ndërmjet të rriturve - prindër/ mësues/

drejtues/ mësues kujdestar - që i bën të rriturit të qëndrojnë lart dhe në fëmijëve që ndihemi si poshtë. Ndaj duhet të forcohen këto marrëdhënie, që ne të mund të kemi besim të komunikojmë me të rriturit kur kemi probleme."

U evidentua një ndjeshmëri nga ana e pjesëmarrësve më të rritur të moshës 16-18 vjeç, në lidhje me komunikimin mes fëmijëve dhe prindërve. Ata u shprehën për rolin dhe marrëdhëniet prind-fëmijë dhe dëshirojnë përfshirje më të madhe dhe më cilësore të prindërve në çështjet apo shqetësimet e tyre.

Fëmijët flasin hapur për diskriminimin dhe në më të shumtën e rasteve e lidhin atë me pranimin në shkollë të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian, fëmijëve me aftësi të kufizuara, apo fëmijëve nga familje të varfra.

Në klasën tonë kemi një nxënës me aftësi të kufizuar... ne përpiqemi me çdo mënyrë ta ndihmojmë që ai mos të ndihet i përjashtuar nga shoqëria jonë, por nxënës të ndryshëm jashtë klasës e tallin dhe e fyejnë atë. Kjo gjë nuk e mërzit vetëm atë...."

Fëmijët janë të ndjeshëm ndaj varfërisë, ndaj kushteve të vështira ekonomike të familjeve në komunitetin e tyre, dhe ndaj fëmijëve të këtyre familjeve në shkollë. Ata shprehën me bindje se, familjeve, u duhet ofruar çdo mbështetje e mundshme, për t'u mundësuar mirërritjen fëmijëve të tyre.

Të gjitha familjeve në nevojë duhet t'u ofrohet ndihmë, që t'i sjellin fëmijët në shkollë dhe ata të mos ndihen keq."

Ka shumë fëmijë, që braktisen nga familja, sepse ata s'kanë mundësi për t'i mbajtur. Këto familje duhet të ndihmohen që të mbajnë fëmijët. Edhe fëmijët që nuk kanë prindër duhen ndihmuar. Ata mund të birësohen nga familje të tjera."

Më të ndjeshëm ndaj kushteve të vështira financiare u shprehën fëmijët, që janë aktualisht në kujdes rezidencial.

"Do të donim të kishim më tepër mundësi për të blerë rroba."

"Çfarë do të bëhet me ne kur të dalim nga këtu? Të kishim të paktën mbështetje për një apartament."

Fëmijët shprehën se nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi çështjet me karakter shëndetësor, veçanërisht ato të shëndetit seksual dhe riprodhues, mbi çështjet që lidhen me drejtësinë për të mitur, dhe në përgjithësi për shërbimet falas që mund të përfitojnë. Për këtë arsye, ata sugjerojnë takime informative periodike, me specialistë të fushave të ndryshme.

"Nuk kemi njohuri për të gjitha shërbimet për fëmijët. Nuk kemi as kontakte me profesionistë të fushave të ndryshme."

“Nuk kemi informacion të mjaftueshëm shëndetësor, nuk mjafton ai që na jepet në shkollë. Me qendrat shëndetësore nuk kemi shumë lidhje. Shkojmë vetëm në spital kur kemi ndonjë shqetësim serioz.”

Me shumë interes janë sugjerimet e fëmijëve, për t’u krijuar atyre hapësirë e mundësi për të diskutuar mbi tematika të ndryshme.

“Përballemi me një mentalitet jo shumë mbështetës ndaj nesh. Kemi nevojë të fuqizohemi dhe ta thyejmë, e të përballemi me të çdo ditë.”

Kërkesa për përfshirje në aktivitete të ndryshme në kohën e lirë, u përsërit vazhdimisht në konsultimet e dedikuara për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për ata në kujdes rezidencial.

“Kemi nevojë për mjedise të përshtatshme për kushtet tona specifike, për të zhvilluar aktivitete sportive, apo thjesht mjedise ku mund të kalojmë kohën e lirë, sidomos gjatë kohës së pushimeve të verës” (Fëmijë me aftësi të kufizuara).

“Dëshirojmë të udhëtojmë e të shohim qytete të tjera, të kemi mundësinë të njohim më shumë përtej këtij institucioni” (Fëmijë në kujdes rezidencial).



Foto kredit: Benzenberg/UNICEF/Albania

Mirëqeverisja në
funksion të promovimit,
respektimit dhe
mbrojtjes së të drejtave
të fëmijëve

1

Objektivi

2


Objektivi

SHTYLLA STRATEGJIKE 1 NË SHIFRA


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (në nr. & %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në nr. & %)



MASAT E BUXHETUARA DHE TË RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në nr. & %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në %	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	Buxheti	Donatorët
1 Realizim	26,535,000.00	29%	25,940,850	98%	6%	94%	
2 Progres	23,947,500.00	27%	19,193,120	80%	77%	23%	
3 Alternim	31,000,000.00	34%	0	0%			
4 Shtyrje	2,225,000.00	2%	0	0%			
5 Mosrealizim	6,249,500.00	7%	0	0%			
Total	89,957,500.00	100%					

OBJEKTIVI 1

Përmirësimi i funksionimit të mekanizmave për të drejtat e fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Në zbatim të masave të parashikuara në Agjendën Kombëtare, gjatë periudhës 2017 – 2018, janë zbatuar nisma të rëndësishme për përmirësimin e kuadrit ligjor për të drejtat e fëmijës:

- Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” u miratua dhe hyri në fuqi në Qershor të vitit 2017 dhe u pasua me miratimin e 18 akteve nënligjore. Kjo paketë ligjore shënon një hap progresiv për forcimin e institucioneve, strukturave dhe mekanizmave, që sigurojnë respektimin e të drejtave të fëmijëve prej individëve, familjes dhe institucioneve shtetërore, si në nivel qendror edhe në atë vendor.
- Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, që hyri në fuqi më 1 janar 2018, forcon në mënyrë të konsiderueshme sistemin e drejtësisë, duke e përafuar atë me standardet dhe normat ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në konflikt apo kontakt me ligjin, bazuar në parimin e mbrojtjes së interesit më të lartë të tyre. Në zbatim të Kodit janë hartuar 7 akte nënligjore dhe 5 urdhra ministrorë. Gjithashtu në kuadër të reformës në drejtësi, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit, si dhe në Ligjin për ndihmën juridike falas, të garantuar nga shteti. Pra, në raport me rreth 27 nisma ligjore të planifikuara për reformimin e sistemit të drejtësisë, 4 prej tyre rregullojnë çështje të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.
- Ligji nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” u mundëson fëmijëve në situata të cënueshme, qasje në programet e strehimit social.
- Ligji nr. 111/2017 “Për Ndihmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, mundëson shërbime profesionale dhe ndihmë ligjore falas për grupet e cënueshme, ku përfshihen fëmijët në konflikt dhe kontakt me ligjin dhe fëmijët, që janë nën kujdes alternativ.
- VKM-të e miratuara në fushën e Arsimit Para-Universitar lehtësojnë ndjekjen e shkollës nga të gjitha kategoritë e fëmijëve, veçanërisht të atyre nga shtresat e rrezikuara të popullatës apo ato në nevojë.

- Ndryshimet e “Ligjit për Regjistrimin Civil”, të “Ligjit për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”
- Përsa i përket masave për fuqizimin e strukturave koordinuese për të drejtat e fëmijëve, nga viti 2017 deri në vitin 2018 është shënuar një rritje me 35.2% të buxhetit të ASHDMF.

Në kuadër të përmirësimit të të dhënave dhe treguesve për fëmijët, shënohet arritje përmes:

- Miratimit të Ligjit 17/2018 “Mbi statistikat Zyrtare”. Ky ligj fuqizon rolin e INSTAT, i cili siguron që çdo agjenci që prodhon statistika zyrtare, përdor standardet, përcaktimet, klasifikimet dhe metodologjinë e Kombeve të Bashkuara dhe të Eurostat-it.
- Publikimit të “Studimit Demografik dhe Shëndetësor për Shqipërinë 2017-2018”, i cili prezanton të dhëna të një game të gjerë, që mundësojnë matjen e progresit në realizimin e të drejtave të fëmijëve në disa fusha. Në të njëjtën kohë, ky studim ofron të dhëna të nevojshme për efekt të raportimeve të progresit që ka bërë Shteti Shqiptar në përmbushje të SDG-ve.
- Administrimit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore të sistemit Sokrates, i cili përfshin në fushat e raportimit, indikatorë për situatën e kategorive të ndryshme të fëmijëve si p.sh. fëmijëve me prindër të ndarë, fëmijëve me aftësi të kufizuar, fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, etj.
- Ngritjes së Prototipit të Sistemit të Integruar

të të Dhënave për Drejtësinë për të Mitur dhe realizimit të trajnimit të parë për përdoruesit e tij.

- Ngritjes pranë Institutit të Shëndetit Publik, të sistemit të mbledhjes së të dhënave për monitorimin e rritjes dhe praktikave të ushqyerjes së fëmijëve, i cili mbledh informacion nga të gjitha konsultoret e fëmijëve në vend.

Si detyrim ndaj Ligjit 18/2017 është miratuar VKM 636, datë 26.10.2018, e cila mandaton ASHMDF-në, të mbledhë të dhëna për 58 indikatorë që targetojnë fëmijët. Kjo listë indikatorësh është në linjë me indikatorët e raportimit të KKBDP dhe me objektivat strategjike të Agjendës për Fëmijët 2017 – 2020.


PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, INSTAT, Bashkitë, UNICEF, UNFPA, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Save the Children, World Vision, Terre des Hommes, organizata kombëtare të shoqërisë civile.


PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018

Në Agjendë, asnjë nga treguesit e rezultatit të objektivit 1, nuk përmban të dhëna fillestare (baseline) dhe target afatmesëm. Përpunimi i informacionit të raportuar nga institucionet përgjegjëse nxjerr përfundimet e mëposhtme.

STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)




STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhënat e mëposhtme: Në këtë kuadër, progresi i 78% të masave të raportuara, paraqitet si më poshtë:

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA


Masat e planifikuara për të vlerësuar ndikimin e ndryshimeve ligjore tek fëmijët kanë mbetur vetëm në kuadër të hartimit të relacioneve shoqëruese. Institucionet raportuese kanë paqartësi për përcaktimin e autoritetit përgjegjës, metodologjisë dhe kapaciteteve të nevojshme, për të kryer vlerësime të kësaj natyre. Buxheti me qendër fëmijët është një fushë veprimi, për të cilën raportimi i Ministrive të linjës reflekton sfidat e tyre për të kuptuar dhe zbatuar aktivitetet e planifikuara. Masa e parashikuar kërkon të zhvillohet në mënyrë periodike analizë buxhetore me qendër fëmijët,

si dhe ngritje kapacitetesh për të buxhetuar me qendër fëmijën. Janë ndërmarrë pak iniciativa në nivel vendor, të fokusuar në tematika të caktuara, të cilat janë promovuar dhe mbështetur kryesisht nga Organizatat Ndërkombëtare.


INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit 1 është rreth 20,8 milionë lekë³ ose 0.9% e kostos së përgjithshme. 47.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët. Institucionet kanë dhënë informacion të plotë për shpenzimet faktike të 33.3% prej masave të buxhetuara dhe informacion të pjesshëm për 13.3% të tyre. Shpenzimet për masat e realizuara janë sa 86.6% e shpenzimeve të planifikuara. 92.6% të shpenzimeve për masat e realizuara është mbuluar nga donatorët. Për një nga masat nën statusin “progres” raportohen më shumë shpenzime sesa kostoja e llogaritur gjatë hartimit të planit të veprimit.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet (në % ⁴)	Shpenzime të realizuara (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve (në %)	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	9,712,500.00	46.6%	8,411,000.00	86.6%	7.4%	92.6%
2 Progres	7,900,000.00	37.9%	17,360,120.00	219.75%	80.6%	19.4%
3 Alternativ	500,000.00	2.4%	0.00	0.00		
5 Mosrealizim	2,712,000.00	13.0%	0.00	0.00		
Total	20,825,000.00	100.0%				

3. Shifra e plotë 20,825,000

4. Përqindjet janë të rrumbullakosura

OBJEKTIVI 2

Avancimi i të drejtave të fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Me koordinimin e MEPJ, Qeveria Shqiptare ka përfunduar procesin e hartimit të Raportit të 5-të dhe të 6-të të Shtetit për Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, për zbatimin e KKBDF dhe protokolleve opsionale në periudhën kohore 2012-2018.

Pranë Kuvendit të Shqipërisë është riaktivizuar Grupi i Deputetëve "Miq të fëmijëve" (GDMF), i cili drejtohet nga Kryetari i Kuvendit dhe përbëhet nga 32 deputetë, 28 anëtarë dhe 3 zëvendëskryetarë. Ky grup ka ofruar hapësirë për dialog me fëmijët, duke mundësuar që 12,700 fëmijë të mund t'u shprehin anëtarëve të Kuvendit opinionet e tyre dhe të ngrenë çështje që i shqetësojnë. Si rezultat i aktivitetit të GDMF është rritur ndërgjegjësimi dhe ndjeshmëria e deputetëve për problemet e fëmijëve, janë adresuar problematika konkrete që lidhen me të drejtat e fëmijëve, duke propozuar dhe miratuar ndryshime në legjislacion. Vetëm gjatë vitit 2018, komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar 18 seanca, në të cilat janë shqyrtuar, diskutuar e miratuar projektligje, të cilat prekin çështje që lidhen me të drejta të fëmijëve,

si dhe janë dëgjuar raportime të ministrave, të përfaqësuesve të ministrive, institucioneve në varësi dhe institucioneve të krijuara me ligj.

Me mbështetjen e organizatave partnere, stafi i AP, përgjegjës për monitorimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror e rajonal, ka fuqizuar kapacitetet e veta në trajtimin e çështjeve që përfshijnë fëmijët, duke marrë cikle të plota trajnimi për kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar të të drejtave të fëmijëve. Gjatë vitit 2017 janë të paktën 85 raste të trajtuara me iniciativën e AP, me objekt të drejtat e fëmijëve. Në vitin 2017, nga totali i 163 ankesave, kërkesave apo inspektimeve, janë zgjidhur pozitivisht apo sqaruar pa rekomandim 44 raste. Gjithashtu janë hartuar 68 rekomandime ku përfshihen edhe rastet e të miturve në konflikt me ligjin, nga të cilat 44 janë në shqyrtim, 23 të pranuar nga administrata dhe 2 të refuzuara. Gjatë vitit 2018 janë trajtuar me iniciativën e AP 94 raste, dhe në total 145 ankesa/kërkesa dhe raste me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga veprimet dhe mosveprimet e organeve të administratës publike. Prejt tyre, 68 raste janë sqaruar, nga të cilat 25 kanë përfunduar me rekomandime.

Për më tepër, institucioni ka nisur hartimin e planit strategjik 4-vjeçar, ku përfshihen aktivitete të detajuara për Komisionerin për të Drejtat e Fëmijës dhe stafit mbështetës të tij.

KDIMDP ka realizuar aktivitete trajnuese me mësuesit, për t'i njohur me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë në Internet. Studimi "Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga grup-mosha 15-18 vjeç" paraqet një analizë të përditësuar të gjendjes së komunikimit përmes internetit, kryesisht përmes rrjeteve sociale të adoleshentëve shqiptarë, si dhe monitoron sjelljet e tyre për ruajtjen e privatësisë online. Zyra e **KDIMDP** ka filluar në vitin 2018 fushatën "Luaj dhe Mëso - Happy Online", për t'u edukuar fëmijëve parimet e mbrojtjes nga rreziqet e pranishme gjatë përdorimit të internetit.

Në 2017-2018, **KMD** ka trajtuar 31 raste me subjekte fëmijët, nga të cilat, 3 ex-officio dhe 28 ankesa. Në përfundim të trajtimit të tyre **KMD** ka konstatuar 5 vendime mos-diskriminimi dhe 6 vendime diskriminimi. Prej këtyre të fundit, 5 vendime janë zbatuar menjëherë prej subjekteve, që kanë shkelur ligjin kundër diskriminimit, një rast tjetër është ankimuar në gjykatë. 7 nga ankesat e marra prej **KMD** nuk plotësonin kriteret për t'u shqyrtuar më tej, në 2 raste çështja është pushuar, kurse në 7 çështje të tjera, procedura e shqyrtimit ka vijuar gjatë vitit 2019. Gjatë 2017-2018, institucioni i **KMD** e shtriu prezencën e tij në tri bashki të tjera nga Tirana. Falë mbështetjes financiare të **KiE** dhe **UNICEF** u hapën tri zyra vendore të **KMD**, duke vijuar më tej, me miratimin nga

Kuvendi të një shtese në buxhetin e institucionit, për t'i mbajtur hapur këto zyra.

Nga **ASHMDF** është hartuar dhe pritët të miratohet "Udhëzuesi mbi Kriteret e Pjesëmarrjes së Fëmijëve", i cili pritët t'u vijë në ndihmë aktorëve institucionalë dhe atyre të shoqërisë civile, për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje, që kanë të bëjnë me jetën e tyre.

Nga monitorimi që **ASHMDF** i bëri medias në vitin 2017, iu referuan strukturave të mbrojtjes së fëmijëve 237 raste të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, të cilat u identifikuan dhe u bënë publike nga media. Përveç kësaj, 70 ankesa iu drejtuan mediave të shkruara dhe audiovizive për publikimin e lajmeve në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve. Prej tyre, 19 ankesa u paraqitën tek Autoriteti i Mediave Audiovizive (**AMA**) dhe, 51 të tjera në gazeta, portale dhe në Këshillin e Mediave Shqiptare.


PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për të Drejtat e Fëmijëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **UNICEF**, **Save the Children**. Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT

2017-2018


STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)



PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN 2017 – 2018

Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA


Shqetësim i institucionit të AP dhe KMD mbetet zbatimi konkret dhe brenda afateve kohore i rekomandimeve të tyre, të cilat janë pranuar nga institucionet përgjegjëse. Gjithashtu, mungesa e burimeve financiare, për të mundësuar zgjerimin e aktiviteteve dhe përmirësimin e shërbimit të ofruar, mbetet problematike. Gjatë periudhës së raportimit nuk ka pasur progres në një sërë masash të planifikuara, që lidhen me këshillat bashkiakë, sektorin e biznesit, pjesëmarrjen e fëmijëve dhe median.


INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit 2 të Agjendës është rreth 69,1 milionë lekë⁵ ose 2.9% e kostos së përgjithshme të zbatimit të saj. 66.9% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiv duhet të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët.

Institucionet kanë dhënë informacion të plotë të shpenzimeve faktike për 31.6% të masave të buxhetuara dhe informacion të pjesshëm për 5.3% prej tyre.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht dhe pjesërisht janë paraqitur

edhe shpenzimet faktike, masat e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat nën statusin "alternim," "shtyrje" dhe "mosrealizim" janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit përkatës, në raport me atë të masave të tjera. Pësha e shpenzimeve faktike për masat nën statusin "realizim" dhe "progres" është sa 28.1% e shpenzimeve totale të planifikuara për objektivin 2.

91.1% e shpenzimeve faktike të raportuara kanë si burim financimi donatorët. Në përgjithësi institucionet qendrore përgjegjëse për zbatimin e masave nuk kanë raportuar shpenzime faktike. Vetëm 19% e Bashkive (nr. 21), që kanë raportuar, kanë realizuar shpenzime për masat e objektivit 2.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ⁶	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	16,822,500	24.33%	17,529,850	104.2%	5.7%	94.3%
2 Progres	16,047,500	23.21%	1,833,000	11.7%	38.5%	61.5%
3 Alternim	30,500,000	44.12%	0.0	0.0		
4 Shtyrje	2,225,000	3.22%	0.0	0.0		
5 Mosrealizim	3,537,500	5.12%	0.0	0.0		
Total	69,132,500	100.0%				

5. Shifra e plotë 69 132 500

6. Përqindjet janë rumbullakosur

SHTYLLA STRATEGJIKE 2

Eliminimi i të gjitha
formave të dhunës ndaj
fëmijëve

3
Objektivi


4
Objektivi

SHTYLLA STRATEGJIKE 2 NË SHIFRA


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (në nr. & %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në nr. & %)



MASAT E BUXHETUARA DHE TË RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në nr. & %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Stadi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në %	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	Buxheti	Donatorët
1 Realizim	16,780,000	9%	1,565,000	9%	3%	97%	
2 Progres	124,212,500	70%	15,662,500	13%	61%	11%	
3 Alternim	600,000	0%	0				
4 Shtyrje	14,025,000	8%	0				
5 Mosrealizim	16,145,000	9%	0				
6 Pa informacion	5,187,500	3%	0				
Total	176,950,000	100%					

OBJEKTIVI 3

Përmirësimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë, për një sistem të integruar dhe efektiv të mbrojtjes së fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Në zbatim të masave të parashikuara për realizimin e objektivit 3, gjatë periudhës 2017 –2018, është shënuar progres për plotësimin e kuadrit ligjor, progres, i cili është raportuar edhe nën objektivin 1. Me miratimin e akteve nënligjore është mundësuar riorganizimi, rishikimi i roleve, përgjegjësive dhe detyrimeve të secilës strukturë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor.

Me Urdhër të Kryeministrit Nr. 40, dt 01.03. 2018 është ngritur Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (KKDMF).

Në kuadër të ngritjes së strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, në fund të vitit 2018, rezultojnë të jenë aktivë 235 PMF, të vendosur në të gjitha bashkitë dhe njësitë administrative. 45 ose 19% e PMF-ve kryejnë vetëm funksionin e PMF-së, të tjerët kryejnë funksione të kombinuara me ato të administratorit social, specialistëve për çështjet gjinore dhe dhunën në familje, etj. Sipas statistikave të ASHMDF për vitin 2018, 79% e NJMF-ve në bashki, raportojnë që menaxhojnë

raste të fëmijëve në rrezik.

Të gjitha PMF raportojnë se kanë ngritur Grupin Teknik Ndër-sektorial (GTN) për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

Bashkitë raportojnë të kenë hartuar planet vendore sociale, ndërkohë në shtesë të kësaj, disa prej tyre kanë hartuar edhe plane specifike vendore për mbrojtjen e fëmijëve. Planet, të hartuara pas një procesi të kujdesshëm të analizës së nevojave, përmbajnë masa veprimi për ngritjen dhe fuqizimin e strukturave vendore të mbrojtjes së fëmijëve, koordinimin ndër-sektorial, ngritjen dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për mbrojtjen e fëmijëve.

Bashkitë që kanë raportuar, i shohin planet vendore si instrumente të mirë për të lobuar për ngritje fondesh. Sikurse raportohet nga ASHMDF:

- 16 bashki kanë hartuar planin social vendor, pjesë e të cilit janë dhe objektivat për mbrojtjen e fëmijës;
- 30 bashki janë në proces të hartimit të planit social vendor;
- 6 bashki kanë hartuar planin social për mbrojtjen e fëmijëve.

Në 2018 është kryer një studim, që hartëzon kapacitetet profesionale dhe nevojat për zhvillim profesional të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve. Pranë Fakultetit të Shkencave Sociale është ngritur kursi pasuniversitar për “Menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje”, si dhe kursi pasuniversitar për “Shërbimet e Kujdesit Alternativ”. Të dyja këto kurse janë ngritur për t’u ofruar trajnim të vazhduar profesionistëve të fushës së mbrojtjes së fëmijëve. Sfidë mbetet akreditimi i këtyre kurseve, si pasojë e ngërçeve procedurale.

Në vijim të miratimit të Ligjit nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”, MSHMS ka ndërmarrë nismën e rishikimit tërësor të paketës së standardeve të shërbimeve, në fushën e kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së fëmijëve.

Në kuadër të vlerësimit të kostove për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, 4 Bashki, përkatësisht Bashkitë e Tiranës, Shkodrës, Durrësit dhe Elbasanit, raportojnë se kanë planifikuar një buxhet minimal për rastet emergjente. Përcaktimi i një zëri buxhetor për menaxhimin e rasteve përbën një arritje, nëse e konsiderojmë se kjo nuk ka ndodhur më parë. Përpos strukturave të NJMF, mekanizmat e raportimit të dhunës funksionojnë edhe pranë institucioneve të tjera. Në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar publik funksionojnë Komisionet e Etikës dhe Komisionet e Disiplinës, mekanizma, të cilat raportojnë dhe trajtojnë rastet e dhunës brenda institucioneve arsimore. Janë bërë rishikime dhe ndryshime strukturore të Policisë së Shtetit, si


në nivel qendror ashtu dhe në nivel vendor, duke përcaktuar funksione të posaçme për të miturit, për të mbështetur raportimin dhe trajtimin e dhunës. Po kështu, me mbështetjen e UNICEF është ruajtur funksionimi i mekanizmit të raportimit, përmes linjës telefonike ALO 116. Për më tepër, prej fillimit të vitit 2019 mbështetja financiare për këtë shërbim mbulohet me fonde të Qeverisë së Shqipërisë/MSHMS.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkitë, Ministri të tjera të linjës. UNICEF, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Save the Children, World Vision, Terre des Hommes, ALO 116.



PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018

STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)



PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN 2017 – 2018

Institucionet përgjegjëse raportojnë informacion si më poshtë:

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (në %)**STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)****SFIDAT E HASURA**

Plotësimi i kuadrit ligjor me aktet përkatëse nënligjore ka sjellë përgjithësisht vonesa në përmbushjen e detyrimeve dhe zbatimin e masave të përcaktuara në këtë Agjendë.

Masat e përcaktuara nën këtë objektiv janë të shumta dhe, në dallim me ato të objektivave të tjerë kërkojnë koordinim dhe bashkëpunim të veçantë ndër-sektorial për t'u zbatuar, veçanërisht mes nivelit qendror dhe atij vendor.

Ka një sërë fushash veprimi apo masash, të cilat mbeten të porealizuara, si:

- analiza dhe rishikimi tërësor i kuadrit ligjor, në të gjithë sektorët e linjës, për ta harmonizuar me Ligjin e ri nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve";

- miratimi i kriterëve për punësimin e punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve dhe ngritja e strukturave për mbrojtjen e fëmijëve në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 18/2017;
- vlerësimi i kapaciteteve të profesionistëve të fushave të ndryshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, hartimi i një plani të harmonizuar për ngritjen e kapaciteteve të tyre, si edhe hartimi i instrumenteve të dedikuara për menaxhimin e rasteve nga këta specialistë;
- vlerësimi buxhetor i kostos për menaxhime të rastit;
- hartimi i modulit të ruajtjes së të dhënave për rastet e menaxhuara, si pjesë e sistemit elektronik të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror;
- monitorimi dhe inspektimi i strukturave të mbrojtjes së fëmijës, bazuar në manuale e udhëzues të përditësuar, në përputhje me Ligjin nr. 18/2017;
- hartimi i programeve të prindërimit pozitiv.

Për strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, si në nivel qendror ashtu dhe në nivel vendor, mbetet sfida mungesa e kapaciteteve në burime njerëzore, në kapacitete teknike dhe burime financiare. ASHDMF mbetet ende me të njëjtën strukturë punonjësish që nga krijimi i saj, duke qenë kështu me kapacitete njerëzore të limituara, edhe pse mandati dhe veprimtaria e institucionit është zgjeruar pas ndryshimeve ligjore të viteve të fundit. Angazhimi i anëtarëve të GTN për të zbatuar detyrimet institucionale, në kuadër të menaxhimit të rastit dhe të ndjekjes së planit individual të mbrojtjes, mbetet ende një sfida. Përveç kësaj, ndryshimi nga institucioni përkatës i anëtarëve të trajnuar të GTN, sjell edhe shkëputje të informacionit

dhe paqëndrueshmëri të këtyre mekanizmave. Planet, qofshin ato sociale apo të dedikuara për mbrojtjen e fëmijës, si në nivel vendor dhe atë qendror, mbeten jo plotësisht të buxhetuara, duke vendosur në pikëpyetje vlerën dhe zbatimin e tyre.

INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit 3 është rreth 161,3 milionë lekë⁶ ose 6.8% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 86.6% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektivi duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët. Institucionet kanë dhënë informacion të pjesshëm të shpenzimeve faktike për 15.8% të masave të buxhetuara. Informacioni është dhënë kryesisht nga 6 Bashki ose 28.6% e Bashkive, që kanë plotësuar instrumentin e buxhetit .

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht dhe pjesërisht janë paraqitur shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat nën statusin “alternim”, “shtyrje”, “mosrealizim” dhe “pa status” janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre, në raport me atë të masave të tjera.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA


Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në %	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	6,180,000	3.8%	0.0			
2 Progres	121,612,500	75.4%	11,262,500	9.3%	84.8%	15.2%
4 Shtyrje	13,350,000	8.3%	0.0			
5 Mosrealizim	16,107,500	10.0%	0.0			
6 Pa status	4,050,000	2.5%	0.0			
Total	161,300,000	100.0%				

6. Shifra e plotë 161 300 000


7. Përqindjet janë rrumbullakosur

Pesha e shpenzimeve faktike për masat nën statusin “realizim” nuk është raportuar nga institucionet përgjegjëse, ndërsa për masat nën statusin “progres”, raportimi është bërë vetëm nga 6 Bashki. Këto njësi kanë raportuar dhe shpenzime të planifikuara për periudhën 2019-2020. Shpenzimet faktike, që raportohen janë sa 7.0% e shpenzimeve totale të planifikuara për realizimin e objektivit 3.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



OBJEKTIVI 4

Përmirësimi i aksesit të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Studimi Kombëtar mbi “Bulizmin dhe Ekstremizimin e Dhunshëm në Sistemin Arsimor Shqiptar” u finalizua me mbështetjen e KiE në fillim të vitit 2017, duke prezantuar gjetje të rëndësishme për shtrirjen e fenomenit dhe, duke ofruar rekomandime konkrete për trajtimin e kësaj problematike.

Gjatë vitit 2018, ky studim u pasua me ofrimin e trajnimeve të akredituara, hartimin e politikave kundër bulizmit dhe prezantimin e një Plani Veprimi (Roadmap). Manuali COMBI – “Komunikim për Ndryshimin e Sjelljes” është akredituar dhe treguesit e tij përdoren zyrtarisht nga specialistët e inspektimit, në inspektimet që zhvillojnë në institucionet arsimore.

Gjetjet reflektohen në raportet e vlerësimit, që hartohen nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) në ndihmë të mësuesve të arsimit parauniversitar. Psikologët e të gjitha shkollave parashikojnë në planin vjetor, tema për t’i njohur fëmijët me llojet e ndryshme të dhunës, keqtrajtimit e abuzimit.

Si rezultat i trajnimeve të vazhdueshme të organizuara nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH), me mbështetjen edhe të partnerëve ndërkombëtarë, kapacitetet e stafeve të 9 institucioneve rezidenciale publike janë fuqizuar në lidhje me legjislacionin

për mbrojtjen e fëmijëve, pasojat e dhunës dhe metodat e disiplinimit pozitiv. Në çdo raport të SHSSH për monitorimin e institucioneve rezidenciale përfshihet objektivi i trajnimit të personelit dhe kërkohet informacion mbi realizimin e aktiviteteve të kësaj natyre. Është draftuar VKM për “Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge”, në të cilin parashikohen detyrimet e institucioneve për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe mbrojtjen e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge.

Është hartuar “Plani Kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019 -2021”, që reflekton angazhimin e institucioneve shtetërore dhe jo shtetërore për të parandaluar, identifikuar dhe ofruar mbrojtje, për çdo fëmijë të gjendur në situatë rreziku dhe abuzimi.

Ka një punonjës të dedikuar në ASHDMF, që monitoron dhe koordinon punën për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge, në bashkitë Tiranë, Elbasan, Korçë, Shkodër dhe Bulqizë. Në këtë fushë i është ofruar

mbështetje teknike edhe PMF-ve të Vlorës, Krujës, Kavajës dhe Durrësit.

UNICEF ka mbështetur realizimin e një hulumtimi sasior me 1000 prindër e 1000 fëmijë të moshës 9-17 vjeç, për t'u njohur me përvojat e tyre gjatë përdorimit të internetit. Gjithashtu, ka përfunduar studimi mbi analizën e kuadrit ligjor, institucional dhe kapaciteteve në fushën e sigurisë online. Të dyja këto studime madhore dhe të rëndësishme pritet të orientojnë rishikimin e masave në këtë fushë veprimi. Është hartuar projektvendimi për "Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesit në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet". Një plan veprimi me detyra dhe përgjegjësi konkrete është nënshkruar mes Autoritetit Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK), MSHMS, MASR, MB dhe Qendrës për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (CRCA) Shqipëri.

Janë zhvilluar fushata ndërgjegjësimi në shkollat 9-vjeçare, në kuadër të ditës së Internetit të Sigurt. Është hartuar manuali për 'Këshilluesit e vegjël mbi Sigurinë Online'. 300 këshillues të moshës 13-14 vjeç janë trajnuar për sigurinë online dhe manuali u është shpërndarë pjesëmarrësve pas trajnimit.

Me fondet e qeverisë, së fundmi është ngritur dhe inauguruar pranë mjediseve të QSUT në Tiranë qendra LILIUM, e cila ofron shërbime të specializuara për fëmijët, që kanë rënë pre e abuzimit seksual, apo formave të tjera të rënda të dhunës. Kjo është e para qendër në Shqipëri, që ofron modelin socio-shëndetësor të shërbimeve, përmes një ekipi multi-disiplinor të përbërë nga mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë,

punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë, dhe që do të japë shërbim të specializuar dhe të integruar sipas standardeve, për 24 orë në çdo ditë të javës.

Është hartuar projektvendimi "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesisim e fëmijës së pashoqëruar", i cili është aktualisht në proces miratimi pranë Këshillit të Ministrave.

Është hartuar dhe miratuar VKM nr.499, datë 29.8.2018 "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit." Në këtë periudhë janë evidentuar, trajtuar dhe marrë në mbrojtje 94 fëmijë, viktimat të mundshme apo viktimat reale të trafikimit. MASR ka siguruar arsimimin e tyre, duke i regjistruar në shkollë dhe, duke iu dhënë tekste falas. Është miratuar Urdhri i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me nr. 172, dt. 08.02.2018 për "Procedurat standarde për përzgjedhjen e shtetasve të huaj të parregullt dhe masat që merren", ku janë integruar dhe përcaktuar masa të veçanta për trajtimin e të miturve. Gjithsesi, ende nuk është hartuar procedura standarde/e posaçme për identifikimin, pritjen dhe trajtimin në Shqipëri të fëmijëve të pashoqëruar, me shtetësi të huaj ose pa shtetësi.


PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Ministria e Brendshme; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Mekanizmi Kombëtar i Referimit, Shërbimi Social Shtetëror; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Bashkitë, UNICEF, Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian, Prezenca e OSBE në Shqipëri, Save the Children, Terre des Hommes, CRCA, Qendra "Fëmijë Sot".

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT

2017-2018


STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)




PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 73% të masave të parashikuara për këtë objektiv.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA


Gjatë hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge, sfida ka qenë kohëzgjatja për vlerësimin e situatës dhe vështirësia për të parashikuar kostot buxhetore. Kjo ka vonuar marrjen e masave konkrete në nivel vendor.

Për një seri masash të planifikuara në Agjendë nuk janë identifikuar institucionet përgjegjëse. Kjo është pjesërisht e lidhur me strukturimin e qeverisë në vitin 2017, apo me mungesën e roleve dhe përgjegjësisë të qarta të institucioneve të ndryshme. Këto janë kryesisht masa, që parashikojnë veprimtari lidhur me standardet e monitorimit për lundrimin e sigurt në internet, forcimin e kapaciteteve në këtë fushë, apo inspektimin e këtyre standardeve. Këto masa duhet të rishikohen, si në perspektivën e domosdoshmërisë së planifikimit të tyre, edhe në kuadër të identifikimit të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për zbatim dhe raportim.

INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e parashikuar për zbatimin e masave të objektivit 4 është rreth 15,8 milionë lekë¹⁰ ose 0.7% e koston së përgjithshme të Agjendës. 81.7% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët. Institucionet kanë dhënë informacion të plotë për shpenzimet faktike vetëm për 8.3% të masave të buxhetuara dhe për 9.5% të masave të pa buxhetuara.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit.

MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



Masat e tjera janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre, në raport me atë të masave të tjera.

Për një nga fushat e objektivit 4 është raportuar financimi i një projekti me vlerë rreth 76 milionë lekë, që përfshin periudhën 2016-2019. Kjo shumë nuk është përfshirë në tabelë, pasi 3 nga masat e përfshira nën këtë fushë nuk janë të buxhetuara. Gjithashtu kjo vlerë është dhënë si buxhet total i projektit dhe jo e detajuar sipas masave të veprimit.

Këto dokumente rregullatorë përfshijnë koncepte të edukimit bazuar në kompetenca, të ndërthurura me elementë të të drejtave të fëmijëve, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit, etj.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ⁸	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	10,600,000	66.9%	1,565,000	14.8%	2.5%	97.5%
2 Progres ⁹	2,600,000	16.4%	4,400,000	169.2%		
3 Alternim	600,000	3.8%				
4 Shtyrje	675,000	4.3%				
5 Mosrealizim	37,500	0.2%				
6 Pa informacion	1,137,500	8.4%				
Total	15,850,000	100.0%				

8. Përqindjet janë rrumbullakosur

9. Për një nga masat me status progres raportohet më shumë shpenzime faktike, sesa kostoja e llogaritur gjatë hartimit të planit të veprimit.


10. Shifra e plotë 15 850 000

Sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijët dhe adoleshentët


Objektivat - 5-14

SHTYLLA STRATEGJIKE 2 NË SHIFRA


STATUSI I REALIZIMIT TË TREGUESVE (në nr. & %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në nr. & %)



MASAT E BUXHETUARA DHE TË RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në nr. & %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në %	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	536,285,000	42%	24,955,400	5%	11%	89%
2 Progres	403,802,000	32%	118,606,689	29%	63%	37%
3 Alternim	61,870,000	5%	952,000	2%		73%
4 Shtyrje	5,957,500	0%	0			
5 Mosrealizim	33,164,368	3%	0			
6 Pa informacion	239,537,500	19%				
Total	1,280,636,368	100%				

OBJEKTIVI 5


Përmirësimi i aksesit dhe i cilësisë së kujdesit dhe edukimit në fëmijërinë e hershme (0 – 6 vjeç)

ARRITJET KRYESORE


MASR, me mbështetjen e UNICEF, ka miratuar “Standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollor” si dhe “Programet e arsimit parashkollor për moshën 3 dhe 4-vjeçare”. Orientimet zyrtare për arsimin gjithëpërfshirës dhe regjistrimin e 5 dhe 6-vjeçarëve në kopsht dhe në klasat përgatitore kanë vijuar të jenë pjesë e udhëzimeve të MASR, në çdo fillim viti shkollor. Njësitë arsimore vendore (Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore Arsimore (ZVA)) hartojnë plane dhe veprimtari për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës. Nga MASR mbledhen rregullisht të dhëna dhe raporte për ecurinë e procesit.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Instituti për Zhvillimin e Arsimit; Institucionet arsimore në nivel vendor; UNICEF.

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018**STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)****PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIUHDHËN 2017 – 2018**

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror jep të dhëna për 100 % të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)

SFIDAT E HASURA

Ende nuk janë hartuar standardet dhe programet e zhvillimit për fëmijërinë e hershme, për fëmijët e moshës 0-3 vjeç. Kjo fushë veprimi mbetet problematike, pasi deri tani nuk ka asnjë iniciativë të zbatuar nga institucionet raportuese, apo të paktën të jetë shprehur si synim i tyre për të ardhmen. Në vijim të avancimit të proceseve decentralizuese dhe transferimit të përgjegjësive nga niveli qendror në atë vendor, këto standarde marrin më shumë rëndësi për t'i ardhur në ndihmë pushtetit vendor në zbatim të detyrave përkatëse. Programet e prindërimit pozitiv pothuajse nuk ekzistojnë, edhe pse Agjenda përcakton qartë synimin e përfshirjes së prindërve dhe familjeve si aktorë të domosdoshëm, për të sjellë ndryshime pozitive në situatën e fëmijëve.

INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e parashikuar për zbatimin e masave nën objektivin 5 është rreth 14,5 milionë lekë¹¹ ose 0.6% e koston së përgjithshme të Agjendës. 60.0% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objekti duhet të mbulohen nga donatorët dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit. Institucionet nuk kanë dhënë informacion për shpenzimet faktike nën të gjithë masat e buxhetuara.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave.

Vetëm për një masë janë planifikuar shpenzime për vitin 2020. Shpenzimet do të mbulohen nga fondet e donatorëve.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në %	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Progres	750,000	5.2%				
2	Mosrealizim	13,752,500	94.8%	0			
	Total	69,132,500	100.0%				

11. Shifra e plotë 14,502,500

12. Përqindjet janë rumbullakosur

OBJEKTIVI 6

Përmirësimi i cilësisë dhe i aksesit të fëmijëve në arsimin e detyruar

ARRITJET KRYESORE

Angazhimi i institucioneve qendrore, për ngritjen e një mekanizmi të përbashkët për identifikimin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor dhe përfshirjen e tyre në shkollë, u ri konfirmua me nënshkrimin e marrëveshjes tri-palëshe “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor” në 12 Korrik 2018, midis MB, MSHMS dhe MASR.

Në vitin 2018, me ndihmën e UNICEF, u përgatit një udhëzim i ri administrativ, për mënyrën sesi duhet ta raportojnë shkollat fenomenin e braktisjes së shkollës. Të gjitha strukturat vendore janë njohur me këtë praktikë. Në katër Bashki, përkatësisht në Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër, ofruesve të shërbimeve në fushën e shëndetësisë, arsimit, policisë, shërbimeve sociale dhe njërive për mbrojtjen e fëmijëve, u është ofruar mbështetje për zbatimin e këtij udhëzimi. Paralelisht me këtë përpjekje u zhvillua një fushatë ndërgjegjësuëse, për të informuar prindërit dhe fëmijët e grupeve në nevojë, për procedurat e regjistrimit të fëmijëve në shkollë.

Sipas VKM nr.682, datë 29.07.2015 i ndryshuar, të gjithë fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe ata me aftësi të kufizuara, përfitojnë transport falas kur institucioni arsimor ndodhet më larg se 2 km nga vendbanimi i tyre.


Është aktivizuar sistemi i të dhënave ROMALB, ku në vitin 2016 janë hedhur të dhëna për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian, si bazë krahasuese për të dhënat që do të regjistrohen në vitet në vijim.

Për fëmijët me shtetësi të huaj, që regjistrohen në kopsht apo në shkollë, ka një plan veprimi, ku veprimtaritë kryesore listojnë:

- Trajtim i veçantë psiko-social nga psikologu i shkollës;
- Punë e diferencuar nga secili mësues, për të përshtatur lëndën me nivelin e gjuhës shqipe që ata zotërojnë;
- Orë shtesë për mësimin e gjuhës shqipe në shkollë, me mësuesin e gjuhës shqipe;
- Përfshirje e tyre në veprimtaritë e shkollës, që ndihmojnë mësimin e gjuhës shqipe dhe përfshirjen e tyre.

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018

STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)




PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Brendshme; Institucionet Arsimore në nivel qendror dhe lokal; Njësitë e Qeverisjes Vendore; UNICEF.

PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIUHDHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)




SFIDAT E HASURA

Sipas udhëzimit nr.17, datë 9.5.2018 të MASR, programi i shansit të dytë nuk do të vijojë më. Të gjithë fëmijët, që ishin përfshirë në programin “shansi i dytë” prej shtatorit të 2018 u regjistruan në klasat e zakonshme dhe me ta punohet brenda shkollës me Plan Edukativ Individual (PEI). Si rrjedhojë, masat e planifikuara në Agjendë për këtë fushë veprimi nuk janë më të vlefshme. Bashkëpunimi ndër-institucional për të përfshirë në shkollë fëmijët braktisës, si dhe bindja e familjeve dhe fëmijëve për t’u rikthyer në shkollë, ka rezultuar një përpjekje relativisht e vështirë.


INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 6 është rreth 236,1 milionë lekë¹³ ose 10.0% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 61.2% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiivi duhet të mbulohet nga donatorët. Institucionet kanë dhënë informacion të plotë për shpenzimet faktike të 35.7% prej masave të buxhetuara.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



13. Shifra e plotë 236 155 000

MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara

plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit.

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 12.1% e shpenzimeve totale të planifikuara nën objektivin 6. Për disa nga masat janë përshkruar shpenzimet, por nuk është specifikuar shuma e shpenzuar nga institucioni përgjegjës. Shpenzime faktike janë raportuar vetëm për masat nën statusin “progres”, por nuk janë raportuar për masat nën statusin “realizim”. Për 37.5% të masave nën statusin “progres” janë planifikuar shpenzime edhe për periudhën 2019-2020. Shpenzimet faktike dhe ato të planifikuara janë bërë me fonde të donatorëve.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

1	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ¹⁴	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Realizim	142,387,500	60.3%				
2	Progres	50,297,500	21.6%	28,633,000	56.2%		100.0%
3	Alternim	42,840,000	18.1%				
	Total	236,155,000	100.0%				

13. Shifra e plotë 236 155 000

14. Përqindjet janë rrumbullakosur

OBJEKTIVI 7

Përmirësimi i mekanizmave për krijimin e mjediseve gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar

ARRITJET KRYESORE

280 shkolla planifikojnë çdo vit veprimtari në kuadër të nismës “Shkolla Qendër Komunitare”. Janë trajnuar të gjithë koordinatoret e shkollave, nxënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit. Vazhdon puna për ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve. Monitorimi i shkollave si qendra komunitare është i vazhdueshëm.

Për vlerësimin e nevojave të profesionistëve të mësuesisë, psikologjisë dhe punës sociale në lidhje me gjithëpërfshirjen i janë nënshtruar testimit rreth 17,000 mësues në të gjithë vendin. U përgatit raporti i studimit dhe u përcaktuan nevojat për mësuesit në sistem, me vjetërsi pune 1-19 vjet. Testimi për përcaktimin e nevojave bëhet çdo 4 vjet sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.11.2017 “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”. Për të realizuar të drejtën për arsim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, MASR në bashkëpunim me UNICEF, Save the Children dhe World Vision ka zhvilluar një Plan Veprimi për Arsimin Gjithëpërfshirës, cili është në koherencë me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të


Kufizuara, përkatësisht me Komentin e Përgjithshëm mbi Arsimin Gjithëpërfshirës. 900 mësues ndihmës janë përfshirë tashmë në sistem, për të rritur aksesin në shkollë për fëmijët me aftësi të kufizuara. MASR ka hartuar gjithashtu projekt-udhëzimin “Mësimi në kushtet e shtëpisë”, ku përfshihet edhe kategoria e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Instituti i Zhvillimit të Arsimit; UNICEF; World Vision; Save the Children.

PROGRESI I TREGUESVETË REZULTATIT 2017-2018


STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)



PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga MASR prezanton të dhëna për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA

Gjatë periudhës 2017 – 2018, masat e parashikuara për Buxhetimin Elastik nuk kanë gjetur zbatim në mënyrë të drejtpërdrejtë. Mungon ekspertiza teknike dhe burimet financiare, për të realizuar një studim apo për të pilotuar modelin e një ndërhyrjeje të tillë.

Plani i veprimit për arsimin gjithëpërfshirës përmban masa, që nuk janë përfshirë në Agjendë dhe që adresojnë përmirësimin e mjedisit dhe shtimin e pajisjeve brenda shkollave të zakonshme, duke synuar gradualisht mbylljen e shkollave speciale dhe kthimin e tyre në qendra burimore.

Nuk ka informacion mbi masat e lidhura me arsimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, që jetojnë në institucionet rezidenciale.


INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 7 është rreth 175,4 milionë lekë¹⁵ ose 7.4% e kostos së përgjithshme të Agjendës.


99.5% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiivi parashikohet të mbulohet nga donatorët.

Institucionet kanë dhënë informacion të plotë për shpenzimet faktike të 12.5% prej masave të buxhetuara.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



15. Shifra e plotë 175 469 368

16. Përqindjet janë rumbullakosur

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat e pa realizuara janë vendosur në tabelë, për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre, në raport me atë të masave të tjera.

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 3.1% e shpenzimeve totale të planifikuara për objektivin 7. Për disa masa janë përshkruar shpenzimet, por nuk

është specifikuar shuma e shpenzuar. Shpenzime faktike janë raportuar vetëm për një nga masat nën statusin “progres”, konkretisht për “Trajnimi i të gjithë personelit mësimor dhe strukturave të tjera brenda shkollës (Qeveritë e Nxënësve, Bordi i Shkollës dhe Këshilli i Prindërve) për krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës në shkollë”

Për këtë masë janë planifikuar shpenzime dhe për periudhën 2019-2020, në masën 8,250,000 ALL. Shpenzimet faktike dhe ato të planifikuara janë bërë me fonde të donatorëve.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ¹⁶	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Realizim	15,700,000	8.9%				
2	Progres	158,850,000	90.5%	5,500,000	3.5%		100.0%
5	Mosrealizim	919,368	0.5%				
	Total	175,469,368	100.0%				

OBJEKTIVI 8

Përmirësimi i proceseve demokratike në shkolla

ARRITJET KRYESORE

Është hartuar dhe miratuar udhëzimi i ri nr.25, datë 25.07.2018 për Bordin e shkollës, i cili u është dërguar zyrtarisht të gjitha institucioneve arsimore të arsimit parauniversitar, për t'u zbatuar gjatë vitit shkollor 2018-2019.

Me hartimin dhe zbatimin e standardeve për Shkollën si Qendër Komunitare janë rritur mundësitë për pjesëmarrje më të gjerë të grupeve të interesit në strukturat qeverisëse të shkollës, veçanërisht për fëmijët dhe prindërit. Me ndihmën e organizatave mbështetëse dhe donatorëve janë realizuar aktivitete fuqizuese për anëtarët e Qeverive të Nxënësve dhe Bordeve të Prindërve. Në fillim të çdo viti shkollor, miratimi i planit vjetor të aktiviteteve të shkollës, përfshin kontributet nga bordi i shkollës, këshilli i prindërve, qeveria e nxënësve.


Në të gjitha shkollat, Qeveritë e Nxënësve realizojnë aktivitete në përmbushje të funksioneve të tyre sipas udhëzimit ekzistues.

Në muajin maj të çdo viti shkollor mbledhen raporte dhe të dhëna statistikore nga çdo njësi arsimore

vendore për rastet, që raportohen dhe trajtohen nga Komisionet e Etikës dhe të Disiplinës, për dhunën brenda institucioneve shkollore. Raporti mes numrit të rasteve të zgjidhura kundrejt atyre të identifikuar raportohet të jetë në masën 100%.

PARTNERËT E PËRFSHIRË


Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Instituti për Zhvillimin e Arsimit; UNICEF; Instituti i Studimeve Politike; Save the Children; World Vision

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018**STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)**

PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIU DHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga MASR prezanton të dhëna për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA

Megjithëse Agjenda parashikon disa përmirësime në funksion të rritjes së pjesëmarrjes së fëmijëve në proceset demokratike të shkollës, nga MASR-ja nuk është parë e nevojshme të ndryshohet udhëzimi për Qeverinë e Nxënësve. Për rrjedhojë, kjo vendimmarrje e MASR-së duhet të reflektohet në Agjendë. Për më tepër, edhe nga grupet e interesit, nuk është paraqitur ndonjë propozim për ndryshimin e këtij udhëzimi.


Vlerësimi i teksteve shkollore në arsimin parauniversitar, nga pikëpamja e edukimit të fëmijëve me vlerat qytetare dhe respektimin e të drejtave të tyre, nuk është raportuar nga institucionet përgjegjëse.

INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 8 është rreth 18,0 milionë lekë¹⁶ ose 0.8% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 61.5% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektivi duhet të mbulohet nga donatorët dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit.

Institucionet kanë dhënë informacion për shpenzimet faktike të 33.3% prej masave të buxhetuara.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



16. Shifra e plotë 18 062 500

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit.

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 7.4% e shpenzimeve totale të planifikuara për zbatimin e objektivit 8. Donatorët kanë raportuar shpenzime faktike për një masë, e cila nuk është buxhetuar në momentin e hartimit të Agjendës. Për masat nën statusin “progres”, shpenzimet faktike të raportuara janë vetëm 10.8% e shpenzimeve të planifikuara, ndërsa për masat nën statusin “realizim”, institucionet nuk kanë raportuar shpenzime faktike.

Shpenzime të planifikuara ka vetëm për një masë, për periudhën 2019-2020. Planifikimi është bërë me fonde të buxhetit të donatorëve.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ¹⁷	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Realizim	5,625,000	31.1%				
2	Progres	12,437,500	68.9%	1,345,000	10.8%		94.4%
	Total	18,062,500	100.0%				

17. Përqindjet janë rumbullakosur

OBJEKTIVI 9

Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në sistemin e drejtësisë

ARRITJET KRYESORE

Është miratuar Ligji nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, si dhe Ligji nr. 35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin e Procedurës Penale”. Këto ndryshime janë në koherencë me KKBDf-në, me standardet dhe normat e tjera ndërkombëtare, që synojnë mbrojtjen e fëmijëve në kontakt dhe konflikt me ligjin, duke u mbështetur në parimin e mbrojtjes së interesit të tyre më të lartë.

Në mbështetje të Kodit për të Miturit u hartuan 12 projektvendime, 5 prej të cilave u miratuan me VKM dhe 7 të tjera janë në proces rishikimi.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që ka hyrë në fuqi më datë 1 qershor 2018, ka caktuar një periudhë tranzitore për ngritjen e mekanizmave, që do të ofrojnë dhe mbikëqyrin ofrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Gjatë kësaj periudhe është miratuar “Strategjia e Drejtësisë për të Miturit” e shoqëruar me Planin e Veprimit, i cili përmban objektiva, aktivitete, indikatorë matës, afate dhe kosto të planifikuara, për një periudhë afatmesme 2018 – 2021. Kjo

strategji përbën dokumentin e parë politik të qeverisë Shqiptare, i cili përcakton shtyllat bazë të reformës për drejtësinë e të miturive.

Që nga hartimi i Agjendës deri tani është ulur ndjeshëm me mbi 80% numri i fëmijëve në paraburgim, si dhe është ulur deri në 22% të rasteve kohëzgjatja e qëndrimit të tyre në këto mjedise.

Në zbatim të detyrimeve të “Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit”, Akademia e Policisë dhe Urdhri i Psikologut kanë hartuar kurrikulat për trajnimin e oficerëve të policisë dhe të psikologëve, që shërbejnë në sistemin e drejtësisë për të miturit. Deri tani janë ofruar trajnime për rreth 543 profesionistë.

Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me Bashkitë e Beratit dhe të Gjirokastrës, për të ndërtuar në vitet e ardhshme një sistem të integruar ndër-sektorial, për t’ju përgjigjur rasteve të të miturve në kontakt apo në konflikt me ligjin.

Po në zbatim të përcaktimeve të Kodit është hartuar Prototipi i Sistemit të Integruar të të Dhënave për

Drejtësinë për të Mitur dhe është kryer trajnimi i parë për përdoruesit e këtij sistemi. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve raporton tregues të përmirësuar të rasteve të recidivizmit.

Në bashkëpunim me Bashkinë e Gjirokastrës, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe SHSSH është ngritur një Qendër pritëse për personat me nevoja të veçanta, ku përfshihen edhe fëmijët me shtetësi të huaj dhe ata pa shtetësi, të cilët janë kapur në kufi apo në territorin e vendit.


Në partneritet me UNICEF është zbatuar programi pilot "Integrimi dhe Ri-integrimi i të miturve në shoqëri nëpërmjet normave, vlerave dhe të jetuarit sipas ligjit", në zonat e Tiranës, Durrësit dhe Pukës. Kjo ndërhyrje kontribuoi në edukimin e 220 të miturve dhe, sidomos të atyre në konflikt me ligjin, për të vepruar dhe jetuar në përputhje me vlerat, normat dhe ligjet në fuqi. Shtyllat kryesore të kësaj ndërhyrjeje ishin: (1) Ndërtimi i një programi prindërimi, i vlefshëm si për prindërit e të miturve në konflikt me ligjin, ashtu edhe të atyre në kontakt me sistemin e drejtësisë apo me policinë, për shkak të viktimizimit, kryesisht nga dhuna në familje; (2) Ofrimi i disa shërbimeve shumë disiplinore, në mbështetje të drejtësisë për të mitur; (3) Mbështetja e Shërbimit të Provës dhe Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP), për të mbështetur të miturit në konflikt me ligjin, të ri-integrohen në shoqëri dhe të orientohen drejt një jete në respektim të ligjit; (4) Krijimi i normave dhe vlerave shoqërore, të cilat i nxitin fëmijët t'i binden ligjit.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Drejtësisë; Shkolla e Magjistraturës; Akademia e Sigurisë; Urdhri i Psikologut; Dhoma Kombëtare e Avokatisë; Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve; Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve; Shërbimi Kombëtar i Provës dhe zyrat e tij vendore; Nëzitë për Mbrojtjen e Fëmijëve; UNICEF; World Vision; Terre des Hommes; Save the Children; Projekti i përbashkët Suedez dhe Shqiptar për Drejtësinë për të Miturit; Rrjeti "Sot për të Ardhmen".

PROGRESI I TREGUESVETË REZULTATIT 2017-2018


STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)



PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA PËR PERIUdhËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA

Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit, me konceptet, parimet dhe mekanizmat e rinj ligjorë që ka parashikuar, përbën risi dhe sfidë për të gjithë profesionistët e fushës së drejtësisë për të mitur. Kësisoj është e nevojshme ngritja e kapaciteteve të të gjithë profesionistëve të përfshirë. Vlen të përmendet se Strategjia e Drejtësisë për të Miturit planifikon masa veprimi më të përditësuara për t'i adresuar këto nevoja.

Ende pritet riorganizimi i gjykatave dhe prokurorive, që të mundësohet krijimi i seksioneve për fëmijët në ato rrethe gjyqësore, ku këto seksione nuk janë ngritur, përveç 7 të tillave që funksionojnë tashmë në Tiranë, Durrës, Korçë, Gjirokastër, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.

Mbetet sfidues përmirësimi i treguesve dhe përcaktimi i metodologjisë, për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, për të gjithë sistemin e drejtësisë.

Bashkëpunimi midis hallkave të sistemit të drejtësisë dhe strukturave të pushtetit vendor, merr rëndësi thelbësore në plotësimin e kuadrit institucional, për të zbatuar në praktikë legjisllacionin e drejtësisë për të miturit.

Në pritje si të organizimit të strukturave që pritet të ngrihen në përputhje me ligjin e ri, ashtu edhe të trajnimit të profesionistëve, mbeten të paidentifikuara rastet e fëmijëve që marrin ndihmë ligjore falas.


Mbetet pas zbatimi i aktiviteteve dhe masave, që parashikojnë ngritjen e modelit të qendrës miqësore për të drejtat e fëmijës, informimin ligjor të fëmijëve dhe familjeve, si dhe edukimin ligjor, përmes përmirësimit të paketës informative kros-kurrikulare, që duhet hartuar si bashkëpunim i MD dhe MASR.

INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 9 është rreth 170,7 milionë lekë¹⁸ ose 7.2% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 79.9% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektivi duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët.

Institucionet kanë dhënë informacion për shpenzimet faktike të 15.8% prej masave të buxhetuara.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara

plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat nën statusin “mosrealizim” dhe “shtyrje” janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre, në raport me masat e tjera. Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 2.2% e shpenzimeve totale të planifikuara për objektivin 9.

Donatorët kanë raportuar shpenzime faktike për një masë, e cila nuk është buxhetuar. Për masat nën statusin “progres”, shpenzimet faktike të raportuara janë vetëm 1.5% e shpenzimeve të planifikuara. Shpenzime të planifikuara për periudhën 2019-2020 ka vetëm për 2 masa. Planifikimi është bërë me fonde të buxhetit të shtetit.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ¹⁹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	8,962,500	5.3%	1,500,000	16.7%	100.0%	
2 Progres	145,780,000	85.4%	2,172,060	1.5%		100.0%
4 Shtyrje	3,595,000	2.1%				
5 Mosrealizim	12,367,500	7.2%				
Total	170,705,000	100.0%				

19. Përqindjet janë rrrumbullakosur

OBJEKTIVI 10

Përmirësimi i aksesit dhe i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor për foshnjat dhe fëmijët

ARRITJET KRYESORE

Për periudhën raportuese, niveli i vdekshmërisë foshnjore për fëmijët nën 1 vjeç është në nivelin 8%, duke e tejkaluar edhe targetin e synuar për vitin 2020 prej 9%. Niveli i vdekshmërisë neonatale, për foshnjat 0-28 ditëshe, shënon vlerën 4/1000 lindje të gjalla, duke arritur targetin e synuar për 2020. Niveli i vdekshmërisë së fëmijëve të moshës 0-5 vjeç është ulur në nivelin 9.2%, duke tejkaluar targetin e synuar për vitin 2020 prej 10%. Niveli i vdekshmërisë amtare është ulur në 10.9%, duke e tejkaluar targetin e synuar për vitin 2020 prej 20%.

Janë hartuar dhe përfshirë në paketën bazë të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor, standardet e shërbimit të konsultoreve të nënës dhe fëmijës. Janë zhvilluar trajnime të ndryshme për profesionistët e fushës, për t'i njohur ata dhe për të vënë në zbatim udhërrëfyesit dhe protokollet përkatëse për shëndetin e gruas shtatzënë,

nënës dhe mirëritjen e fëmijës. Në vitin 2018 është ngritur një grup pune, për rishikimin dhe përditësimin e standardeve të kujdesit shëndetësor parësor, punë, e cila pritet të përfundojë gjatë 2019.

MSHMS ka hartuar programin dhe protokollet për ndjekjen e shëndetit amtar dhe të të porsalindurit, në situatat e emergjencave civile. Personeli i qendrave shëndetësore po trajnohet për zbatimin e këtyre dokumenteve.

Në Durrës është pilotuar qasja multi-disiplinore e ofrimit të shërbimit në Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (DROSHKSH) (ish Drejtoria Rajonale e Shëndetit). Kjo është realizuar përmes zbatimit të ndërhyrjes “Bashkë për shëndetin e fëmijëve me aftësi të kufizuar”, që ka pasur në fokus rritjen e kapaciteteve të punonjësve, në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor, përsa lidhet me identifikimin dhe referimin në kohë të fëmijëve me aftësi të kufizuar të shërbimet shëndetësore.

Sistemi Informativ i Vaksinimit është përmirësuar dhe është gati për t'u testuar, para se të shtrihet në 4 rajone të tjera.

Gjatë vitit 2018, Shërbimi i Psikiatrisë dhe Klinika e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë, hartuan protokollat e trajtimit të disa prej çrregullimeve më të shpeshta të shëndetit mendor, që hasen tek fëmijët dhe adoleshentët. Këto protokolle janë të zbatueshme nga të tre nivelet e ofrimit të kujdesit shëndetësor (Primar, Sekondar dhe Terciar). Protokollat e miratuara, që janë publikuar edhe në faqen zyrtare të MSHMS janë:


- Protokollin Klinik për trajtimin e depresionit tek fëmijët dhe adoleshentët;
- Protokollin e Kujdesit Diagnostik dhe Terapeutik për Çrregullimet Obsesivo-Kompulsive të Fëmijëve dhe Adoleshentëve;
- Protokollin Diagnostik dhe Terapeutik për sjelljet vetë-dëmtuese të fëmijëve dhe adoleshentëve.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Brendshme; UNICEF.

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018


STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)




PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA PËR PERIU DHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 87% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (në %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA

Nën arkitekturën institucionale të sektorit shëndetësor janë prezantuar rishtazi DQOSHKSH. Këto struktura duhet të gjejnë hapësirën e duhur në Agjendë, me role dhe përgjegjësi të qarta për ushtrimin e funksionit të tyre, si dhe me detyrimet për të raportuar për zbatimin e saj.

INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 10 është rreth 217,6 milionë lekë²⁰ ose 9.2% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 95.8% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiivi duhet të mbulohet nga donatorët.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ²¹	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	211,475,000	97.2%				
2 Progres	5,220,000	2.4%				
3 Alternim	250,000	0.1%				
6 Pa informacion	637,500	0.3%				
Total	217,582,500	100.0%				

Institucionet përgjegjëse nuk kanë dhënë informacion për shpenzimet faktike të të gjitha masave të këtij objektiivi.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Masat nën statusin "pa informacion" janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre, në raport me atë të masave të tjera.

97.2% e shpenzimeve janë parashikuar për 30.0% të masave të planit. Institucioni përgjegjës i ka raportuar masat nën statusin "realizim", por nuk ka informacion për shpenzimet faktike të periudhës 2017-2018.

Për periudhën 2019-2020 janë planifikuar shpenzime vetëm për një masë. Planifikimi është bërë me buxhet të donatorëve.

20. Shifra e plotë 217 582 500

21. Përqindjet janë rumbullakosur

OBJEKTIVI 11

Krijimi i mjedisit mbështetës për ofrimin e praktikave optimale të ushqyerjes së foshnjave dhe fëmijëve

ARRITJET KRYESORE

Aktualisht, mbi 50 për qind e të gjithë materniteteve në Shqipëri janë certifikuar si Spitale Miqësore me Foshnjat, duke iu përmbajtur procesit me 10 hapa të ushqyerjes me gji brenda mjedisëve të maternitetit. Kjo është një nismë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH)-UNICEF për të mbështetur dhe mbrojtur ushqyerjen me gji.

Në vitin 2017-2018, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) kreu një studim të kuadrit ligjor dhe politik, që mbështet programin kombëtar të integruar shumë-sektorial të ushqyerjes nëpër shkolla, vlerësimin e situatës dhe njohurive rreth ushqyerjes, si dhe qasjeve dhe praktikave të zakonave të ushqyerjes tek fëmijët në moshë shkollore. Studimi që është në rang kombëtar, pritet të botohet së shpejti.

Në prill të vitit 2018, me vendim të Ministrit të MSHMS-së, u krijua Komiteti Kombëtar për Çrregullimet e Pamjaftueshmërisë Jodike. Ky

Komitet ka rishikuar Ligjin nr. 9942, datë 26.6.2008 i ndryshuar "Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut" dhe ka hartuar projektligjin e ri. Ndryshimet e propozuara në projektligj lidhen me mënyrën e kryerjes së kontrollit, për të përcaktuar nivelin e jodit në mostrën e kripës së jodizuar. Projektligji përcakton edhe institucionet, që do të kryejnë monitorimin dhe inspektimin e kontrollit të kripës së jodizuar. Këto ndryshime bazohen në rekomandimet e OBSH-së, Këshillit Ndërkombëtar për Kontrollin e Çrregullimeve të Mungesës së Jodit (ICCIDD) dhe UNICEF-it. Aktualisht Projektligji është në proces për t'u miratuar.


Pranë ISHP është ngritur sistemi i mbledhjes së të dhënave për monitorimin e rritjes së fëmijëve, si dhe për praktikën e ushqyerjes, i cili mbledh informacion nga të gjitha konsultoret e fëmijës në shkallë vendi. Është trajnuar 100% e personelit shëndetësor, i cili duhet të raportojë të dhëna bazuar në këtë sistem.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Drejtorinë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor; Drejtoritë e Shëndetit Publik; Autoriteti Shëndetësor Rajonal; UNICEF; Organizata Botërore e Shëndetësisë.

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018


STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)




PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIUHDHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 50% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (në %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA

Nga raportimi vihet re se nuk janë realizuar masat, që lidhen me kuadrin rregullator dhe monitorimin e përmbajtjes së produkteve ushqimore në institucionet arsimore. Për këtë parashikohej nënshkrimi i një memorandumi tri-palësh midis ish-Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit (tani Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZhR), MSHMS dhe MASR. Nuk ka informacion për shkaqet, që kanë penguar zbatimin e një mase të tillë.

Gjithashtu mungon informacioni për hartimin e planit të komunikimit për praktikën e ushqyerjes së të porsalindurve dhe foshnjave. Mungesë informacioni ka edhe për trajnimin e inspektorëve lidhur me zbatimin e dietës ushqimore në kopshte dhe çerdhe.

INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 11 është rreth 20,4 milionë lekë²² ose 0.9% e koston së përgjithshme të Agjendës. 61.7%

e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektivi duhet të mbulohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët.

Institucionet përgjegjëse kanë dhënë informacion të plotë të shpenzimeve faktike për 20.0% prej masave të buxhetuara.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat nën statusin “mosrealizim” dhe “pa informacion” janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre në raport me buxhetin e masave të tjera.

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 26.7% e shpenzimeve totale të planifikuara për objektivin 11. Për masat nën statusin “realizim” dhe “progres”, shpenzimet faktike janë më të mëdha sesa shpenzimet e planifikuara. Burimi i financimit të këtyre masave kanë qenë fondet e donatorëve. Për periudhën 2019-2020 shpenzime të planifikuara ka vetëm për 2 masa, të cilat mbulohen me buxhet të donatorëve.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ²³	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	1,750,000	8.6%	2,750,000	157.1%		100.0%
2 Progres	1,150,000	5.6%	2,700,000	234.8%		100.0%
5 Mosrealizim	1,650,000	8.1%				
6 Pa informacion	15,900,000	77.8%				
Total	20,450,000	100.0%				

23. Përqindjet janë rrumbullakosur

OBJEKTIVI 12

Përmirësimi i sistemit shëndetësor dhe i shërbimeve, që ofrohen për adoleshentët, duke i bërë ato miqësore për ta


ARRITJET KRYESORE

Integrimi dhe zbatimi i kurrikulës për edukimin gjithëpërfshirës të shëndetit seksual në klasat 4-12 ka sjellë realizimin e masës, që lidhet me edukimin seksual dhe promovimin e sjelljeve të shëndetshme. MASR raporton se është përgatitur paketa kurrikulare përkatëse dhe janë realizuar trajnime për edukimin seksual në 13 ish-Drejtori Arsimore Rajonale.

Aktualisht një grup teknik pune po harton Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve dhe Adoleshentëve.


PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; UNFPA.


PROGRESI I TREGUESVETË REZULTATIT 2017-2018**STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVETË REZULTATIT (në %)****PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA PËR PERIUDHËN 2017 – 2018**

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 33% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVETË VEPRIMIT (në %)



STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA

Për tri fusha veprimi institucionet përgjegjëse nuk kanë paraqitur informacion, dhe si rrjedhojë nuk njihet progresi mbi përmirësimin e kuadrit rregullator për kujdesin shëndetësor ndaj adoleshentëve; ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve cilësore për adoleshentë; si edhe monitorimin e cilësisë së shërbimit për këtë target.

Është raportuar mungesë burimesh financiare për të realizuar trajnimin e mësuesve; për të monitoruar edukimin seksual gjatë procesit mësimor; si dhe


hartimin e një plani komunikimi për ndryshimin e sjelljeve mbi shëndetin seksual dhe riprodhues tek të rinjtë.

INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave për objektivin 12 është rreth 166,4 milionë lekë²⁴ ose 7.0% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 59.2% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektivi duhet të mbulohet nga donatorët dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit.

Institucionet kanë dhënë informacion të plotë për shpenzimet faktike, për 50.0% të masave të buxhetuara dhe nuk kanë raportuar për pjesën tjetër të tyre.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



24. Shifra e plotë 166 380 000

MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)

Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 1.9% e shpenzimeve totale të planifikuara për objektivin 12.

OJF-të dhe institucionet përgjegjëse kanë raportuar shpenzime faktike për 2 masa, që kanë statusin “pa informacion”. Për një masë, që është nën statusin “progres”, shpenzimet faktike janë rreth 2.3 herë më të mëdha sesa shpenzimet e planifikuara.

Për periudhën 2019-2020 shpenzime të planifikuara ka vetëm për 3 masa, të cilat mbulohen me buxhete të donatorëve.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat nën statusin “shtyrje”, “mosrealizim” dhe “pa informacion” janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre në raport me buxhetin e masave të tjera.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Id	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në % ²⁵	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
2	Progres	1,350,000	0.8%	3,175,000	235.2%		100.0%
4	Shtyrje	1,350,000	0.8%				
5	Mosrealizim	4,250,000	2.6%				
6	Pa informacion	159,430,000	95.8%				
	Total	166,380,000	100.0%				

25. Përqindjet janë rrumbullakosur

OBJEKTIVI 13

Fuqizimi i mekanizmave dhe i kapaciteteve, për të ofruar mbrojtje dhe përkujdes shoqëror më të mirë, ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve në nevojë

ARRITJET KRYESORE

Mbledhja e të dhënave në kuadër të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (EU-SILC) është realizuar nga INSTAT, edhe pse publikimi i rezultateve pritet të ndodhë në vitin 2019. Kjo Anketë do të sigurojë të dhëna mbi varfërinë, përfshirë edhe atë të fëmijëve, sipas modulit të dedikuar për të matur dhe raportuar deprivimin material të fëmijëve, që u prezantua në vitin 2017, me mbështetjen e UNICEF.

Në kuadër të projektit “Modernizimi i Asistencës Sociale” të zbatuar nga MSHMS në bashkëpunim me Bankën Botërore është realizuar studimi mbi vlerësimin e dinamikës së përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike, si dhe janë përgatitur pyetësorët për vlerësimin e impaktit të skemës, pas

shtrirjes së saj në shkallë vendi. Ndërkohë, vetëm në vitin 2018, janë mbështetur përmes kësaj skeme rreth 36,711 familje me fëmijë. Është hequr ndihma e pjesshme dhe jepen subvencione shtesë për ndjekjen e arsimit të detyrueshëm dhe vaksinimin. Për më tepër, është rritur masa mesatare përfituese e ndihmës ekonomike nga 3,500 në 5,600 lekë, që përbën rritje me 37.5% të saj.

Ligji nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror” është plotësuar me hartimin e 14 projekt-vendimeve; ndërkohë që 9 VKM janë miratuar, 5 të tjera janë në proces miratimi.

Është përcaktuar modaliteti financiar dhe formula financiare, që mundëson financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel vendor, prej Fondit Social në nivel qendror.

Është draftuar dhe është në proces konsultimi, projektligji “Për mbrojtjen sociale”. Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së ndihmës ekonomike, pagesave të aftësisë së kufizuar dhe bonusit të bebeve, për të garantuar mbrojtje sociale për të gjithë qytetarët. Gjithashtu projektligji synon mbështetje për familjet dhe individët në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave jetike bazë, për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara social ekonomike.

Me mbështetjen e UNICEF është hartuar metodologjia e përgatitjes së planeve vendore sociale. Procesi i hartimit të planeve sociale ka qenë gjithëpërfshirës. Hartimi i tyre ka përfshirë përfaqësues të sektorëve të ndryshëm, që kanë rol në garantimin e mbrojtjes sociale, përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve. Veç të tjerash, ky proces ka shërbyer edhe si një mundësi për ngritjen e kapaciteteve të aktorëve vendorë, për të mbledhur dhe analizuar të dhënat, për të vlerësuar nevojat dhe për të planifikuar shërbimet e nevojshme. Në total, SHSSH raporton se në krahasim me vitin 2016 janë ngritur 10 shërbime të reja me fokus fëmijët.

Në zbatim të ligjit 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” janë rishikuar dhe miratuar 5 standarde, nga të cilat 2 për fëmijët. Këto janë udhëzimi nr. 16/2018 “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës, për rastet e dhunës seksuale”, dhe udhëzimi nr. 582/2017 “Për miratimin e standardeve për qendrat shtëpi-familje për fëmijët 16-18 vjeç”.


Udhëzimi i fundit ishte i lidhur ngushtësisht me hapjen e një kategorie të re institucionesh rezidenciale, të dedikuara për adoleshentët e moshës 16-18 vjeç.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Shërbimin Social Shtetëror dhe Bashkitë; INSTAT; UNICEF; Banka Botërore; Terre des Hommes; Save the Children etj.



PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018

STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)



PROGRESI I MASAVETË PARASHIKUARA PËR PERIUdhËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 92% të masave të parashikuara nën këtë objektiv.

STATUSI I RAPORTIMIT TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)**STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)****SFIDAT E HASURA**

Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës përfaqëson një metodologji të re, realizimi i së cilës paraqet kompleksitet, duke kërkuar kështu më tepër kohë në dispozicion për konsolidimin e publikimin e gjetjeve dhe të analizës.

Pavarësisht plotësimit të paketës ligjore, hartimit të instrumenteve financiare dhe planifikuese, akoma mbeten shumë sfida në nivel qendror dhe vendor,

deri në ngritjen e shërbimeve për fëmijët në të gjitha Bashkitë.

Ndërkohë që janë rishikuar disa standarde, akoma nuk ka ndryshim ose rritje të strukturave monitoruese dhe atyre të inspektimit. Këto masa në Agjendë mbeten të perealizuara.

Përtej ngritjes së qendrës rezidenciale për fëmijët e grup-moshës 15 – 17 vjeç nuk janë marrë masa të tjera, për të mundësuar aftësimin për jetën dhe përgatitjen e tyre për të jetuar të pavarur.

INFORMACION MBI BUXHETIN

Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 13 është rreth 200,6 milionë lekë²⁶ ose 8.5% e kostos së përgjithshme të Agjendës. 57.9% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektivi duhet të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër nga donatorët. 14.6% e kostos së objektivit është vlerësuar si hendek financiar. Institucionet kanë dhënë informacion të plotë për shpenzimet faktike të 32.0% prej masave të buxhetuara, por nuk kanë dhënë informacion për 68.0% të tyre.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat nën statusin “mosrealizim”, “shtyrje” dhe “pa informacion” janë vendosur në


26. Shifra e plotë 200 644 500

tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre në raport me buxhetin e masave të tjera.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



Pesha e shpenzimeve të planifikuara për masat nën statusin "realizim" dhe "progres" është sa 86.7% e shpenzimeve totale të planifikuara për objektivin 13.

79.3% e shpenzimeve faktike të raportuara janë financuar nga buxheti i shtetit. Ndërsa shpenzimet faktike të raportuara për masat nën statusin "realizim" janë financuar në masën 95.9% nga donatorët.

Institucionet kanë raportuar shpenzime rreth 5 herë më të larta, sesa kostoja e vlerësuar për një masë nën statusin "progres".

Realizimi i shpenzimeve për masat nën statusin "realizim" është vetëm sa 13.9% e kostonë së planifikuar. Asnjë nga masat e këtij objekti nuk raportohet të jetë buxhetuar për periudhën 2019-2020.

SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në %	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
					Buxheti	Donatorët
1 Realizim	146,110,000	72.8%	20,255,400	13.9%	4.1%	95.9%
2 Progres	27,967,000	13.9%	75,081,629	268.5%	99.5%	0.5%
3 Alternim	17,732,500	8.8%	254,000	1.4%		100.0%
4 Shtyrje	300,000	0.1%				
5 Mosrealizim	225,000	0.1%				
6 Pa informacion	8,310,000	4.1%				
Total	200,664,500	100.0%				

OBJEKTIVI 14

Fuqizimi i familjes për të adresuar rreziqet dhe pasojat e varfërisë, si dhe për të parandaluar ndarjen e fëmijës nga familja

ARRITJET KRYESORE

Është miratuar VKM nr. 56, datë 31.1.2018 "Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara", e cila krijon mundësinë për adresimin e papunësisë së familjeve vulnerable, përfshirë familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuar dhe të atyre në kujdes rezidencial.

Në kuadër të përpjekjeve të bëra për fuqizimin e familjeve në adresimin e rreziqeve të varfërisë dhe në parandalimin e ndarjes së fëmijëve nga familjet e tyre, vërehet progres në rritjen e përvitshme të numrit të familjeve me fëmijë, që dalin nga skema e ndihmës ekonomike përmes skemave të nxitjes së punësimit. Vetëm në vitin 2018 janë punësuar rreth 3,740 individë, pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dhe kanë kryer kurse të zhvillimit profesional 609 individë.

Një tjetër mbështetje është mundësuar për familjet, përmes VKM 740, datë 12.12.2018 'Për

përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) për nënat me foshnja të porsalindura dhe proceduart e dhënies së tij'.

Është plotësuar kuadri ligjor për ngritjen e ndërmarrjeve sociale përmes miratimit të VKM nr. 789 datë 26.12.2018 "Për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale", VKM nr. 716, datë 1.12.2017 "Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së ndërmarrjes sociale", si edhe VKM nr. 16, datë 12.1.2018 "Për miratimin e listës së veprimtarive që ushtrojnë ndërmarrjet sociale", edhe pse ende nuk ka filluar subvencionimi i ndërmarrjeve të para sociale.

Në kuadër të raportimit për treguesit e rezultatit të Agjendës evidentohet ndër vite ulje e numrit të fëmijëve, që hyjnë në institucionet rezidenciale, nga 87 në vitin 2016 në 69 fëmijë në vitin 2017.

Gjithashtu evidentohet rritje e numrit të fëmijëve në familje kujdestare, nga 226 në vitin 2016 në 287 në vitin 2018.


Është hartuar dhe ka nisur zbatimin i Planit Kombëtar të De-Institucionalizimit. Si rezultat i kësaj nisme janë ngritur 9 skuadra terreni, të përbëra nga profesionistë të fushës së mbrojtjes së fëmijëve me përvojë në fushën e shërbimeve dhe menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Kjo fazë e zbatimit parashikon një vlerësim të thelluar të situatës aktuale dhe historikut personal dhe familjar të fëmijëve në kujdes rezidencial në 9 institucione publike. Në të njëjtën kohë, ka nisur edhe procesi i vlerësimit të situatës dhe i kapaciteteve të familjeve biologjike, për ri-integrimin e fëmijëve në familje.

PARTNERËT E PËRFSHIRË

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Bashkitë, UNICEF, Save the Children, organizatat: NISMA për Ndryshim Shoqëror, Arsis, Bethany Social Services.

PROGRESI I TREGUESVE TË REZULTATIT 2017-2018


STATUSI I REALIZIMI TË TREGUESVE TË REZULTATIT (në %)



PROGRESI I MASAVE TË PARASHIKUARA PËR PERIU DHËN 2017 – 2018

Informacioni i raportuar nga institucionet përgjegjëse prezanton të dhëna për 100% të masave të parashikuara nën këtë objektivi.

STATUSI I REALIZIMI TË MASAVE TË VEPRIMIT (në %)



SFIDAT E HASURA

Plotësimi i paketës së akteve nënligjore të Ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror”, për të qartësuar përbërjen, funksionimin dhe detyrat e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit pranë Bashkive, ka vijuar edhe gjatë vitit 2018, gjë që ka sjellë vonesa në ngritjen e këtyre strukturave në nivel lokal. Si rrjedhojë, masat e parashikuara për të vlerësuar nevojat, për të hartuar planet dhe manualët e ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve, nuk janë realizuar.

Plani për De-Institucionalizimin ende nuk është buxhetuar. Me mbështetjen e UNICEF, kjo masë pritet të përmbushet gjatë gjysmës së parë të vitit

2019. Buxheti i planit do t'i hapë rrugë edhe miratimit të planit me VKM të posaçme.

INFORMACION MBI BUXHETIN


Kostoja e vlerësuar për zbatimin e masave nën objektivin 14 është rreth 6 milionë lekë²⁷ ose 0.3% e kostos së përgjithshme Agjendës. 63.4% e shpenzimeve për zbatimin e këtij objektiwi duhet të mbulohen nga donatorët dhe pjesa tjetër nga buxheti i shtetit. Institucionet kanë dhënë informacion të plotë për shpenzimet faktike të 33.3% prej masave të buxhetuara.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shpenzimet e planifikuara, të grupuara sipas statusit të progresit të masave. Për masat e raportuara plotësisht janë paraqitur edhe shpenzimet faktike, masa e realizimit të shpenzimeve dhe burimi i financimit. Masat nën statusin "alternim" dhe "shtyrje" janë vendosur në tabelë për të evidentuar peshën e buxhetit të tyre në raport me buxhetin e masave të tjera.

Shpenzimet faktike janë raportuar vetëm për 2 nga 4 masat e realizuara nga institucionet përgjegjëse. Niveli i shpenzimeve të raportuara është sa 10.5% e shpenzimeve të planifikuara, ndërsa për masat

nën statusin "alternim" raportimi është siguruar vetëm për 1 masë. Për këtë objektivi janë raportuar shpenzime faktike për një masë nën statusin "alternim". Shuma e shpenzimeve faktike të raportuara është rreth 2 herë më e madhe se shumta e planifikuara. Shpenzimet për këtë masë janë kryer në masën 100% nga donatorët. Shpenzimet faktike të raportuara janë sa 19.0% e shpenzimeve totale të planifikuara për objektivin 14.

MASAT E BUXHETUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



MASAT E RAPORTUARA ME INFORMACION FINANCIAR (në %)



SHPENZIMET E PLANIFIKUARA DHE ATO FAKTIKE MBI MASAT E RAPORTUARA

Id	Statusi i progresit	Shpenzime të planifikuara (në lekë)	Shpenzimet në %	Shpenzime faktike (në lekë)	Realizimi i shpenzimeve në %	Burimi i financimit	
						Buxheti	Donatorët
1	Realizim	4,275,000	70.8%	450,000	10.5%	100.0%	
3	Alternim	1,047,500	17.4%	698,000	66.6%		100.0%
4	Shtyrje	712,500	11.8%	0.0			
Total		6,035,000	100.0%				

27. Shifra e plotë 6 035 000

Reflektime mbi planet e së ardhmes

Instrumentet e përdorur për monitorimin e progresit afatmesëm të Agjendës synuan të mbledhnin edhe informacion mbi vlefshmërinë e aktiviteteve dhe indikatorëve të planifikuar në Agjendë për periudhën 2019 – 2020. Por, informacioni i mbledhur ishte i pamjaftueshëm për të përcaktuar me saktësi shkallën e ndryshimeve të nevojshme të çdo aktiviteti.

- Përfundimet në vijim janë përpunuar nga tërësia e informacionit të raportuar dhe janë bazuar në një këndvështrim më të gjerë të Agjendës, si instrument strategjik ndër-sektorial për të avancuar të drejtat e fëmijëve.
- Raporti i monitorimit afatmesëm të Agjendës duhet të shikohet në mënyrë të integruar me Raportin e 5-të dhe 6-të Periodik të Shtetit Shqiptar për Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Bashkërisht, këto dy Raporte duhet të ushqejnë planifikimin e masave relevante për vitet e ardhshme, në funksion të zbatimit të plotë të çdo të drejte të fëmijëve në Shqipëri dhe në përgjigje të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.
- Nga viti 2016, kur u hartua kjo Agjendë, kuadri rregullator i të drejtave të fëmijëve ka pësuar ndryshime thelbësore. Këtu numërohen miratimi i Ligjit për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Kodit të Drejtësisë Penale për Fëmijët, Strategjisë Kombëtare e Drejtësisë për të Miturit; Planit të Veprimit për Sigurinë Online, Planit të Veprimit për Arsimin Gjithëpërfshirës, Planit Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Ekonomik, etj. Janë në proces hartimi i Strategjisë së Arsimit Para-universitar, Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve dhe Adoleshentëve, Strategjisë për Mbrojtjen Sociale, etj. Këto dokumente e procese të rëndësishëm duhet të merren parasysh nga ana e institucioneve, për të artikuluar vlefshmërinë e masave të së ardhmes, dhe për të harmonizuar qasjen ndaj institucioneve.
- Me ndryshimet e ndodhura në kuadër të reformës së decentralizimit dhe kalimit të përgjegjësive nga niveli qendror në nivel vendor, roli i Bashkive duhet të forcohet, duke marrë dhe përgjegjësitë e duhura për

shumë prej masave, të cilat janë parashikuar në Agjendë, përkundrejt aktorëve të tjerë institucionalë. Për këtë arsye është e nevojshme të ri diskutohen përgjegjësitë dhe të qartësohen rolet, duke i reflektuar ato në Agjendë për vitet në vijim. Bashkitë do të duhet të jenë pjesë më aktive e hartimit të politikave të mbrojtjes shoqërore dhe mbrojtjes së fëmijëve. Pavarësisht se kanë qenë pjesë e proceseve konsultuese, përfshirja e tyre që në planifikimin dhe specifikimin e masave, do të rrisë përgjegjshmërinë e tyre në zbatim.

- Paralelisht me reformën e decentralizimit, vitet e fundit janë shënuar disa ndryshime të

tjera në ristrukturimin e disa institucioneve të rëndësishme kombëtare, duke pasur kështu institucione të reja përgjegjëse, për zbatimin dhe raportimin e disa masave të rëndësishme në Agjendë.

Ky raport ka evidentuar se ekziston një mospërputhje e planeve të masave dhe atyre që janë realizuar konkretisht. Praktikisht ka 30% të masave, që janë shtyrë ose nuk janë realizuar. Gjithçka që përmendet më lart, si edhe problematikën e shprehura në treguesit e Agjendës, veçanërisht të buxhetimit të masave, orientojnë drejt fillimit të një procesi rishikimi të kujdesshëm dhe realist të masave, për vitet në vazhdim.

Shtojcat

Shtojca 1: Lista e institucioneve raportuese

Institucione në nivel qendror:

Institucioni
Kuvendi
Avokati i Popullit
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Shërbimi Social Shtetëror
Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Ministria e Brendshme
Ministria e Drejtësisë
Drejtoria e burgjeve
Shërbimi i provës
Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural
AKU
Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
INSTAT
ASHMDF
Ministri i Shtetit për Diasporën
Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
Ministria e Kulturës
AKCESK
AMA

Institucione në nivel vendor:

Institucioni
Belsh
Cërrik
Divjakë
Finiq
Fushë-Arrëz
Himarë
Kamzë
Kavajë
Klos
Kolonjë
Korçë
Krujë
Kukës
Kurbin
Lushnjë
Mat
Patos
Peqin
Përrenjas
Pukë
Roskovec
Sarandë
Skrapar
Vau i Dejës
Vlorë
Shkodër

Organizata të Shoqërisë Civile:

Save the Children
Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin
Vatra
Terre des Hommes
UNICEF

2017-2018 | **RAPORTI I
MONITORIMIT
AFATMESEM**
TË AGJENDËS KOMBËTARE
PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

